





Diversifikimi i ofertës mësimore

Manual për shkollat profesionale



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:


swisscontact

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Prof. Asoc. Dr. Erka Çaro, Zv. Menaxhere Projekti dhe Oltjon Valisi, Menaxher Linje për Diversifikimin e Ofertës në AFP.

Autorë:

Aurora Guxholli

Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Kontributorë:

Florie Bega

Bardh Dedgjonaj

Dorina Dudi

Rudina Gjoka

Ermira Mani

Dr. Anila Nanaj

Gjenovefa Xhakaj

Merita Zeneli

Aleka Papa

Rreth projektit “Aftësi për Punë” (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti “Aftësi për Punë” (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përfuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Pronësia intelektuale

© Ky publikim është pronësi ekskluzive intelektuale e projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Publikimi mund të aksesohet, lexohet, shkarkohet apo printohet vetëm për përdorim personal. Ndalohet riprodhimi, shpërndarja, shitja, shfaqja, ndryshimi apo përshtatja e çdo materiali që përfshihet në publikim pa autorizim nga S4J.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

TABELA E PËRMBAJTJES

Akronime	4
Fjalorth	5
1. Hyrje	6
2. 1.1 Diversifikimi i ofertës mësimore në AF	6
1.2 Roli i sektorit privat në diversifikimin e ofertës mësimore AF	7
1.3 Sfidat e diversifikimit të ofertës mësimore në AF	8
3. Qëllimi i manualit	8
2.1 Përgatitja e manualit	8
2.2 Struktura e manualit	9
2.3 Përdorimi i manualit	9
4. Procesi i diversifikimit të ofertës mësimore në AF	10
3.1 Analiza e nevojave	10
3.1.1 Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve	11
3.1.2 Analiza e ofertës mësimore të shkollës	13
3.1.3 Analiza e ofertës mësimore në nivel kombëtar	14
3.1.4 Analiza e gjurmimit të të diplomuarve	16
3.1.5 Analiza e treguesve socio-ekonomikë	17
3.1.6 Analiza e praktikës profesionale në biznes	18
3.1.7 Analiza e nevojave të kompanive	19
3.1.8 Analiza e këndvështrimit të nxënësve	25
3.1.9 Përgatitja dhe diskutimi i raportit të gjetjeve	29
3.2 Marrja e vendimit	31
3.2.1 Analiza e kapaciteteve për lëvrimin cilësor të ofertës së re mësimore	32
3.2.2 Marrja e vendimit për ofertën e re mësimore	33
3.2.3 Në rast çeljeje të një kualifikimi të ri	34
3.2.4 Në rast ofrimi të një moduli të ri me zgjedhje të detyruar	39
3.3 Planifikimi për lëvrim	39
3.3.1 Planifikimi i përgjithshëm për lëvrimin e ofertës së re mësimore	40
3.3.2 Promovimi i ofertës së re mësimore	46
Referenca	
Shtojca	

AKRONIME

AF	Arsim Profesional
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
IOAFP	Institucion Ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
NjZh	Njësia e Zhvillimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
S4J	Skills for Jobs (Projekti “Aftësi për Punë”)

FJALORTH

AFP (Arsimi dhe Formimi Profesional) është një fushë e aftësive profesionale, që kombinon arsimin me praktikën profesionale, e cila i pajis individët me njohuri e shprehi të veçanta, si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t'u punësuar në një profesion të caktuar dhe për t'u integruar në tregun e punës.

AKAFPK (Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve) është institucioni publik përgjegjës për krijimin e sistemit të unifikuar të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe për kualifikimin e trajnimit e vazhduar të mësuesve/instruktorëve të arsimit profesional.

IOAFP (Ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional) është institucioni publik ose jopublik (person fizik ose juridik), i licencuar dhe/ose i akredituar për të ofruar programe/shërbime të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.

Korniza Europiane Referuese për Sigurimin e Cilësisë në AFP përmban një cikël sigurimi dhe përmirësimi të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit të AFP-së, që mbështetet nga kriteret e përbashkëta të cilësisë, përshkruesit indikativ dhe treguesit.

KShK (Korniza Shqiptare e Kualifikimeve) është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh për nivele specifike të të nxënimit të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit e të cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

Lista Kombëtare e Profesioneve klasifikon profesionet, bazuar në llojin e punës e në kompetencat e nevojshme dhe përbëhet nga emërtimet përkatëse të profesioneve/punëve e nga përshkrimet e profesioneve.

Qendra Shumëfunksionale e AFP-së është një ofrues i arsimit dhe formimit profesional, që ka mandatin ligjor dhe kapacitetin për të ofruar arsim profesional të mesëm dhe pas të mesmes, si dhe formim profesional për të rinjtë e të rriturit.

Sistemi i AFP-së është sistemi, ku përfshihen të gjithë përbërësit e AFP-së dhe institucionet, të cilat e mbështesin atë, përfshirë dhe ofruesit e AFP-së.

1. HYRJE

Arsimi dhe formimi profesional mund të luajnë një rol të rëndësishëm për përgatitjen e të rinjve për të hyrë sa më herët dhe me lehtësi në tregun e punës. Edhe pse një fushë e anashkaluar në të shkuarën, sa vjen e më shumë vende po e njohin rëndësinë që ka arsimi dhe formimi profesional cilësor për ekonominë konkurruese. Sidomos në kohët e sotme kur pritet që, shumë shpejt, profile të caktuara pune të zhduken apo të transformohen, diversifikimi i ofertës mësimore në AFP është një mundësi e mirë që shoqëria t'i përballojë me sukses këto ndryshime. Edhe në Shqipëri, tashmë prej tri dekadash, arsimi dhe formimi profesional është përfshirë në një proces reformimi të vazhdueshëm që synon përshtatjen me kërkesat e tregut të punës dhe rritjen e punësueshmërisë së nxënësve dhe kursantëve që përgatiten në kuadrin e këtij sistemi. Një komponent shumë i rëndësishëm i këtij reformimi është edhe diversifikimi i ofertës mësimore të shkollave profesionale. Por çfarë nënkupton diversifikimi i ofertës mësimore?

1.1 Diversifikimi i ofertës mësimore në AF

Diversifikimi i ofertës mësimore në kuadër të shkollave profesionale nënkupton përshtatjen e vazhdueshme të ofertës mësimore të shkollës me kërkesat gjithnjë në ndryshim të tregut të punës, veçanërisht në nivel vendor dhe rajonal. Kjo përfshin jo vetëm përditësimin e programeve mësimore por edhe ofrimin e kualifikimeve të reja për të cilat ka nevojë tregu rajonal i punës. Sipas një raporti¹ (2019) të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), diversifikimi i ofertës mësimore është një nga dy komponentët kryesorë me anë të të cilëve AFP siguron përmbushjen e nevojave të tregut të punës në vend. Komponenti i dytë i rëndësishëm është mundësia që shkollat profesionale u ofrojnë nxënësve për të ndjekur kualifikime në nivelin pas të mesëm. Nevoja për diversifikim të ofertës mësimore identifikohet nga vetë shkolla profesionale në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat të rajonit. Oferta e re mësimore i propozohet ministrisë së linjës dhe, pas miratimit, zbatohet po në bashkëpunim të ngushtë me kompani të sektorit privat.

Procesi i diversifikimit të ofertës mësimore kërkon angazhimin e shumë aktorëve brenda shkollës, bashkëpunim të vazhdueshëm dhe efikas me sektorin privat, dhe mbi të gjitha përkushtim dhe kohë. Ai është i rëndësishëm për pajisjen e nxënësve me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për punësim dhe zhvillim profesional të suksesshëm. Si i tillë, procesi i diversifikimit të ofertës mësimore ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e motivimit të nxënësve për të mësuar, shtimin e numrit të regjistromeve të reja në shkollë, si dhe në rënien e numrit të nxënësve që braktisin shkollën.


Në këtë manual, diversifikimi i ofertës mësimore është konceptuar si një proces i cili zbatohet nëpërmjet tri fazave kryesore. Procesi nis me analizën e nevojave të tregut të punës përkundrejt ofertës mësimore në lëvrim të shkollës. Në rastet kur identifikohen nevoja për kualifikime profesionale të nevojshme në treg, bazuar në kapacitetet profesionale dhe infrastrukturale dhe mbështetjen që ofrojnë kompanitë e sektorit privat përkatës, shkolla mund të vendosë të hapë një kualifikim të ri. Në mënyrë që oferta e re mësimore të zbatohet me sukses, shkolla planifikon me kujdes zbatimin për vitin shkollor në

¹ OECD. (2019). Education Indicators in Focus.

https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2019/04/what-characterises-upper-secondary-vocational-education-and-training_7ae872d8/a1a7e2f1-en.pdf

vijim. Secila fazë mund të zbatohet nëpërmjet disa hapave. Përdoruesit e këtij manuali vlen të kenë parasysh natyrën sugjeruese të tij; ndërkohë që procesi i përshkruar këtu bazohet në përvojat disa vjeçare të disa shkollave profesionale në vend, është në dorën e vetë shkollës ta përshtasë sipas nevojave dhe mundësive.

Grafiku i mëposhtëm paraqet procesin e diversifikimit të ofertës të sugjeruar në këtë manual.



1.2 Roli i sektorit privat në diversifikimin e ofertës mësimore AF

Kompanitë e sektorit privat luajnë një rol thelbësor në procesin e diversifikimit të ofertës. Nëpërmjet tyre, shkolla informohet për nevojat e tregut të punës për njohuri, aftësi dhe kompetenca të caktuara, të cilat më pas ajo i përkthen në kualifikime të reja. Përpos informimit, bashkëpunimi i vazhdueshëm me kompanitë e rajonit siguron përfshirjen e specialistëve nga sektori privat në hartimin e materialeve të nevojshme mësimore për kualifikimin e ri, si për shembull module me zgjedhje të detyruar apo lëndë të natyrës teorike apo praktike. Përfaqësues të ndryshëm nga kompanitë private mund të ftohen nga shkolla edhe për të dhënë mësim në fushat ku ata janë specialistë. Me rëndësi të veçantë për aftësimin praktik të nxënësve është edhe realizimi i praktikave profesionale në kompani të ndryshme. Kjo përvojë mund të shpjerë edhe në punësimin e tyre të mundshëm në të ardhmen. Shkolla i rishikon vazhdimisht marrëveshjet me sektorin privat në varësi të nivelit të përkushtimit dhe mundësive për mbështetje të këtij të fundit.



1.3 Sfidat e diversifikimit të ofertës mësimore në AF

Procesi i diversifikimit të ofertës mësimore në arsimin profesional përballet me disa sfida që ndikojnë në zbatimin dhe përmirësimin e tij. Një nga vështirësitë kryesore është përafrimi i kërkesave të ndryshme të tregut të punës me kapacitetet dhe burimet e shkollave, përfshirë burimet njerëzore dhe infrastrukturën e nevojshme. Shkollat shpesh përballen me mungesë të specialistëve të kualifikuar për të mbuluar lëndë të reja apo module të avancuara që kërkohen nga tregu. Po ashtu, bashkëpunimi afatgjatë dhe i qëndrueshëm me kompanitë e sektorit privat mund të jetë sfidues për shkak të ndryshimeve në përkushtimin e kompanive ose mungesës së burimeve financiare dhe logjistike. Sigurimi i mjediseve të përshtatshme për praktikat profesionale për të gjithë nxënësit është një tjetër pengesë, sidomos në zonat ku bizneset e sektorëve të kërkuar janë të pakta. Gjithashtu, procesi i zhvillimit të kualifikimeve të reja nga autoritetet shpesh kërkon kohë të gjatë, duke penguar kështu shkollat të reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve në tregun e punës.

2. QËLLIMI I MANUALIT

Qëllimi i këtij manuali është që t’u ofrojë shkollave profesionale në vend sugjerime praktike për zbatimin me sukses të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore. Manuali bazohet te përvojat e shkollave profesionale të përfshira në projektin “Aftësi për punë” (S4J) në diversifikimin e ofertës mësimore, në veçanti të mësimet e nxjerra nga zbatimi i këtij projekti, por dhe tek parimet bazë të diversifikimit të ofertës mësimore dhe praktikat më të mira bashkëkohore në vendet europiane. Në këtë kuptim, manuali jo vetëm dokumenton njohuritë e përfutura gjatë viteve të zbatimit të projektit “Aftësi për punë” (S4J), por edhe siguron shpërndarjen e gjerë të këtyre njohurive për realizimin me sukses të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore në të gjitha shkollat profesionale në vend.

Objektivat kryesore të këtij manuali janë:

- përmbledhja e informacionit rreth procesit dhe praktikave më të mira të deritanishme të shkollave profesionale në kuadër të diversifikimit të ofertës mësimore;
- ndarja me gjithë shkollat profesionale në vend të këtyre praktikave, të integruara në një proces të orientuar;
- ofrimi i një tërësie instrumentesh mbështetëse për të lehtësuar zbatimin e procesit të diversifikimit të ofertës mësimore nga shkollat profesionale në vend.

2.1 Përgatitja e manualit

Praktikat e zbatuara në vite në kuadër të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore nga shkollat profesionale të përfshira në projektin “Aftësi për punë” (S4J) janë prezantuar dhe diskutuar në disa takime pune të organizuara nga projekti. Procesi i detajuar sipas tri fazave dhe hapave shoqërues, përfshirë dhe praktikat e mira dhe shembuj nga produktet e punës në secilën fazë janë diskutuar me aktorët e përfshirë në procesin e validimit derisa është arritur dakordësimi i të gjitha palëve mbi një produkt përfundimtar. Në konsultim të vazhdueshëm me skuadrën e projektit “Aftësi për Punë” (S4J) dhe përfaqësues nga shkollat profesionale, u strukturuan dhe u plotësuan materialet deri në finalizimin e një manuali me natyrë sugjeruese për diversifikimin e ofertës mësimore në të gjitha shkollat profesionale në vend.

2.2 Struktura e manualit

Ky manual është konceptuar si një mjet praktik për të orientuar dhe mbështetur shkollat profesionale në procesin e diversifikimit të ofertës mësimore. Për realizimin e këtij manuali është mbledhur një spektër i gjerë përvojash nga disa shkolla profesionale në vend, përvoja të cilat janë analizuar me kujdes nga specialistë të arsimit dhe formimit profesional. Procesi i diversifikimit të ofertës mësimore i sugjeruar në këtë manual është validuar nga shkollat profesionale të përfshira në zbatimin e projektit “Aftësi për punë” (S4J).

Manuali paraqet tri fazat kryesore të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore. Secila fazë detajohet në hapa dhe nën hapa, të paraqitura në rend kronologjik. Për secilin hap, jepen sugjerime për zbatimin sa më të lehtë e me sukses dhe parashtrihen sfida të mundshme për të cilat përdoruesi është mirë të përgatitet paraprakisht. Disa prej hapave ilustrohen me shembuj nga praktika të mira të shkollave profesionale të përfshira në projekt. Praktikrat në fjalë synojnë t’i ofrojë përdoruesit ide për praktika të mira e të mundshme në zbatimin e hapit përkatës. Në fund të manualit, përdoruesi do të gjejë një sërë instrumentesh të përgatitura si mjete ndihmëse që lehtësojnë zbatimin e procesin të diversifikimit të ofertës mësimore.

2.3 Përdorimi i manualit

Edhe pse i bazuar në përvoja të pasura të një numri shkollash profesionale në vend, manuali ka një natyrë praktike në kuptimin që lejon përdoruesin ta përshtasë zbatimin e tij sipas nevojave dhe mundësive të momentit. Ky manual është hartuar për t’i ardhur në ndihmë strukturave të ndryshme të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e diversifikimit të ofertës mësimore. Këto strukturat janë:

- Bordi Drejtues
- Drejtoria
- Departamentet mësimore
- Njësia e zhvillimit
- Sekretaria mësimore
- Ekipi i vetëvlerësimit

Gjithashtu, ky manual synon t'u vijë në ndihmë aktorëve të ndryshëm të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e diversifikimit të ofertës mësimore. Këta aktorë janë:

- Drejtuesi i shkollës
- Koordinatori i kurrikulës
- Koordinatori i marrëdhënieve me biznesin
- Koordinatori për orientimin në karrierë
- Koordinatori i gjurmimit
- Koordinatori për marketingun institucional
- Koordinatori i zhvillimit të vazhduar profesional
- Përgjegjësit e departamenteve mësimore
- Instruktorët e praktikës profesionale

3. PROCESI I DIVERSIFIKIMIT TË OFERTËS MËSIMORE NË AFP

Oferta mësimore shqyrtohet rregullisht nga vetë shkolla profesionale. Diversifikimi i ofertës mësimore është përgjegjësi e shkollës dhe arrihet si rezultat i punës së bashkërenduar ndërmjet strukturave të ndryshme institucionale brenda dhe jashtë shkollës. Procesi i diversifikimit të ofertës që sugjerohet këtu kalon në tri faza kryesore. Këto faza janë:

- (1) Analiza e nevojave
- (2) Marrja e vendimit
- (3) Planifikimi për zbatim

Në vijim zërthehet secila fazë sipas hapave përkatës. Secili hap ndjek një objektivi të caktuar dhe përmbillet me një produkt përfundimtar që mbështet hapin në vijim.


3.1 ANALIZA E NEVOJAVE

Faza e parë e diversifikimit të ofertës mësimore, *analiza e nevojave*, ka për synim të identifikojë nevojat e tregut të punës për aftësi profesionale të munguara dhe të kërkuara, në qytetin/rajonin ku ndodhet shkolla. Analiza e nevojave drejton institucionin ofrues të arsimit profesional, të hapë një drejtim, profil apo kualifikim të ri, i cili përmbush nevojat e tregut të punës. Kjo fazë sugjerohet të kryhet gjatë periudhës

janar – maj. Analiza e nevojave sugjerohet të përfshijë disa hapa, si në figurën në vijim, duke filluar me përgatitjen e një kalendari aktiviteteve për identifikimin e nevojave për diversifikimin e ofertës në vitin e ardhshëm mësimor. Në vijim, sugjerohet të merren në shqyrtim oferta e tanishme e shkollës profesionale dhe oferta kombëtare e kualifikimeve. Pasi analizohet situata e të diplomuarve nga shkolla profesionale në tregun e punës, vlen të merren në shqyrtim treguesit demografikë dhe socio-ekonomikë. Në këtë fazë të parë, sugjerohet të kryhen edhe analiza e praktikave profesionale në biznes, analiza e nevojave të kompanive për aftësi profesionale dhe punonjës të kualifikuar, si dhe analiza e këndvështrimit të nxënësve të shkollës profesionale. Personat përgjegjës për zbatimin e fazës së parë të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore, *analizës së nevojave*, mund të jenë:

- (a) drejtuesi i shkollës profesionale
- (b) koordinatori i kurrikulës
- (c) koordinatori i marrëdhënieve me biznesin
- (d) koordinatori për orientimin në karrierë
- (e) koordinatori i gjurmimit
- (f) përgjegjësit e departamenteve
- (g) sekretaria mësimore
- (h) mësimdhënës të praktikës profesionale

Në figurën më poshtë paraqiten hapat e sugjeruar të fazës së analizës së nevojave.



Figurë: Hapat e Fazës së parë - Analiza e nevojave

Në vijim paraqitet një përshkrim më i detajuar i hapave të punës si dhe proceseve që mund të realizojnë personat e angazhuar, në fazën e analizës së nevojave.

3.1.1 Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve

Hapi i parë i analizës së nevojave për diversifikimin e ofertës mësimore, sugjerohet të nisë me përgatitjen e kalendarit të aktiviteteve për identifikimin e nevojave për diversifikimin e ofertës në nivel ofruesi (shkurt, *kalendarit të aktiviteteve*). Për këtë, me anë të një urdhëri të brendshëm (**Shtojca 1**), drejtuesi i shkollës profesionale mund të emërojë një grup pune të përbërë nga:

- drejtori i shkollës profesionale,
- përgjegjësi i NjZh-së
- koordinatori i kurrikulës
- koordinatori i marrëdhënieve me biznesin
- koordinatori i gjurmimit

Grupi i punës mund të strukturojë punën si më poshtë:

- të hartojë nje plan kalendar aktiviteteve, për kryerjen e analizës së nevojave për diversifikimin e ofertës mësimore;
- të përcaktojë personat përgjegjës për mbikqyrjen dhe realizimin e secilit aktivitet, bazuar në nevojat dhe mundësitë e shkollës profesionale;
- të përcaktojë afatet kohore për realizimin e secilit aktivitet.

Pasi grupi i punës harton kalendarin e aktiviteteve dhe dakordëson atë, vijohet me miratimin nga drejtuesi i shkollës profesionale të kalendarit të aktiviteteve. (**Shtojca 2**).

Në vijim sugjerohet që koordinatori i kurrikulës t'i shpërndajë stafit mësimor kalendarin e aktiviteteve, në mënyrë që të gjithë të jenë të informuar për procesin.

Hapi i parë, *përgatitja, miratimi dhe shpërndarja e kalendarit të aktiviteteve*, sugjerohet të kryhet gjatë muajit janar.



Sugjerime për përgatitjen e kalendarit të aktiviteteve

- Etapat, proceset, mënyrat e realizimit të aktiviteteve, të prezantuara e përshkruara në këtë fazë, (si në tërësi në këtë manual) nuk janë të detyrueshme e as shteruese, ato janë sugjerime për të ardhur në ndihmë shkollave profesionale, mbështetur mbi eksperiencat e koleksionuara dhe të validuara nga shkollat profesionale, që kanë kaluar tashmë përmes këtyre proceseve. Aplikimi i tyre, është në diskrecionin e shkollave.
- Kalendarit të aktiviteteve mund të bazohet në fazat dhe hapat e parashtruara dhe të sugjeruara në këtë manual, të përshtatura me nevojat dhe mundësitë e shkollëve profesionale.

- Kohëzgjatja për secilin aktivitet është mirë të planifikohet në mënyrë realiste, për të shmangur përjasje apo vonesa në kohë mes aktiviteteve.
- Mënyra sesi grupet e punës marrin vendime, ndikon jo vetëm në entuziazmin dhe përkushtimin ndaj procesit të punës, por edhe në zbatimin e vendimeve që merr grupi. Kjo vlen veçanërisht për grupet që planifikojnë procese të gjata e të bashkërenduara pune. Prandaj, sugjerohet që grupi i punës për përgatitjen e kalendarit të aktiviteteve, të diskutojë hapur dhe me mirëkuptim të ndërsjellë për procesin e diversifikimit të ofertës mësimore, deri në dakordësim të një procesi që përfaqëson idetë dhe besimit e gjithësecilit.



Vështirësi që mund të hasen gjatë përgatitjes së kalendarit të aktiviteteve

Një pengesë e mundshme në realizimin e hapit të parë në kohë, mund të jetë dërgimi me vonesë nga AKAFPK, i informacionit për skelet-kurrikulat e reja apo të rishikuara. Përvoja e shkollave profesionale, tregon se informacioni për skelet-kurrikulat, mund të mos jetë gati brenda muajit janar, çfarë pengon grupin e punës të përgatisë në kohë kalendarin e aktiviteteve, për analizën e nevojave të diversifikimit të ofertës mësimore. Në të tilla raste sugjerohet që grupi i punës të planifikojë me kujdes aktivitetet në vijim, duke lënë disa diapazone tolerante kohe, për të rikuperuar kohën e humbur, si rezultat i kësaj pengese në fillim të procesit.

3.1.2 Analiza e ofertës mësimore të shkollës profesionale

Pas hartimit të kalendarit të aktiviteve, sugjerohet që drejtuesi i shkollës profesionale, me mbështetjen e koordinаторit të kurrikulës dhe të sekretarisë mësimore, të marrë në shqyrtim ofertën në lëvrim të shkollës. Oferta në lëvrim mund të shqyrtohet në dy plane:

a. Oferta mësimore në lëvrim dhe ofertat e mëparshme

Drejtuesi i shkollës profesionale, krahason ofertën mësimore në lëvrim me ofertat e mëparshme, duke marrë në shqyrtim drejtimet, profilet, modulet me zgjedhje dhe programet e aftësimi/kualifikimit të

nivelit pas të mesëm. Analiza ndihmon në informimin rreth trendeve dhe mundëson parashikime për ndryshimet e mundshme në ofertën mësimore. Për rezultate sa më të sakta, sugjerohet marrja në analizë e ofertave mësimore në 3-5 vitet e fundit. Për këtë, sekretaria mësimore mund të asistojë procesin duke vendosur në dispozicion dokumentet si më poshtë:

- listë e drejtimeve të tanishme
- listë e drejtimeve të mëparshme
- listë e profileve sipas çdo drejtimi të tanishëm
- listë e profileve sipas çdo drejtimi të mëparshëm
- listë e programeve të tanishme të aftësisit/kualifikimit pas të mesëm
- listë e programeve të mëparshme të aftësisit/kualifikimit pas të mesëm

Krahasimi i ofertës mësimore në lëvrim me ofertat e mëparshme, paraqitet në një pasqyrë përmbledhëse, që sugjerohet të japë informacion ndër të tjera edhe për:

- qëndrueshmërinë e drejtimeve dhe të profileve të ndryshme mësimore, si dhe të kualifikimeve profesionale në nivelin pas të mesëm, në vite.
- efektin e rishikimeve të ofertës mësimore në vite, si për shembull zbatimin me sukses ose jo të një drejtimi apo profili mësimor, apo kualifikimi profesional në nivelin pas të mesëm, etj.

b. Të dhënat administrative të shkollës

Përkrah analizës krahasimore të ofertës mësimore në lëvrim me ato të mëparshme, drejtuesi i shkollës profesionale, me mbështetjen e koordinаторit të kurrikulës, vlen të shqyrtojë edhe të dhënat administrative të shkollës profesionale. Këto të dhëna mund të përfshijnë:

- Numrin e regjistrimeve, të çregjistrimeve, pezullimeve dhe diplomimeve sipas drejtimeve, profileve apo programeve pas të mesmes, që shkolla ka në lëvrim.
- Numrin e regjistrimeve, të çregjistrimeve, pezullimeve dhe diplomimeve sipas drejtimeve, profileve apo programeve pas të mesmes, në 3-5 vitet e mëparshëm.
- Numrin e të punësuarve në përputhshmëri me profilin e diplomimit.

Për një listë kontrolli të të dhënave të rekomanduara për analizën e ofertës mësimore të shkollës profesionale, mund të konsultohet **Shtojca 3**.

Hapi i dytë, *analiza e ofertës mësimore të shkollës profesionale*, sugjerohet të kryhet gjatë muajit janar.



Sugjerime për analizën e ofertës mësimore të shkollave profesionale

Analiza e ofertës mësimore aktuale mund të zhvillohet si në procesin më poshtë:

- Hartohet një tabelë përmbledhëse, ku pasqyrohet informacion për ofertën mësimore në vite.
- Identifikohen dhe analizohen cilat prej drejtimeve/profileve/kualifikime profesionale pas të mesme, janë të qëndrueshme në ofertën mësimore.
- Identifikohen dhe analizohen cilat drejtime/profile/kualifikime profesionale pas të mesme, janë rikonceptuar, mbështetur në dinamikat e tregut të punës.
- Identifikohen dhe analizohen cilat drejtime /profile/ kualifikime profesionale pas të mesme, rezultojnë të suksesshme ose jo.

3.1.3 Analiza e ofertës mësimore në nivel kombëtar

Përkrah analizës së ofertës mësimore të shkollës profesionale, gjatë fazës së parë të analizës së nevojave vlen të realizohet edhe analiza e ofertës mësimore në nivel kombëtar dhe rajonal, në terma të drejtimeve, profileve dhe programeve profesionale të nivelit pas të mesmes. Për ofertën mësimore kombëtare, mund të merret në shqyrtim skelet-kurrikula si dhe ofertat mësimore të shkollave profesionale, nga rajone të ndryshme të vendit, përfshi dhe rajonin ku ndodhet shkolla profesionale në fjalë. Ky informacion mund të sigurohet në faqen zyrtare të AKAFPK². Në këtë mënyrë, para se të hartojnë sugjerimet për diversifikimin e ofertës, drejtuesi i shkollës profesionale dhe koordinatori i kurrikulës, sugjerohet të identifikojnë ofruesit e tjerë të programeve profesionale, në nivel kombëtar dhe rajonal. Në rast identifikimi të ofruesve të programeve të njëjta apo të ngjashme në nivel kombëtar dhe rajonal, koordinatori i kurrikulës shqyrton raportin e kërkesës me ofertën në rajonin ku ndodhet shkolla profesionale. Nëse kërkesa është më e lartë se oferta, atëherë koordinatori i kurrikulës analizon më tej kërkesën e pambuluar nga oferta vendore. Analiza e ofertës mësimore në nivel kombëtar dhe rajonal sugjerohet të kryhet gjatë muajit janar.

Ky hap realizohet në dy plane:

a. Konsultimi me ofertën mësimore sipas kualifikimeve kombëtare

Koordinatori i kurrikulës konsulton skelet-kurrikulën e AKAFPK-së³ dhe Udhëzuesin e AKAFPK-së për shkollat profesionale publike, në kuadrin e fillimit të vitit të ri shkollor, me synim analizën e ofertës mësimore sipas kualifikimeve kombëtare.

b. Shqyrtimi i ofruesve të tjerë në rajon

² <https://www.akafp.gov.al/tabela-e-struktures-se-skeletkurrikula/>

³ <https://www.akafp.gov.al/tabela-e-struktures-se-skeletkurrikula/>

⁴ <https://aftesi.puna.gov.al/>

Drejtuesi i shkollës profesionale, shqyrton ofertat e shkollave profesionale të tjera në rajon lidhur me drejtimet, profilet dhe programet mësimore të nivelit pas të mesmëm që ato ofrojnë.



Sugjerime për analizën e ofertës mësimore në nivel kombëtar

- Gjatë shqyrtimit të ofertave mësimore rajonale, grupi i punës mund të konsultohet edhe me informacionin që mund të sigurojë në faqen zyrtare të AKPA⁴, ku mund të gjejë informacion për ofertën e të gjitha shkollave profesionale.
- Ky informacion e ndihmon grupin e punës siguron informacion se cilat janë kapacitetet lokale aktuale për aftësitë, me qëllimin që të mund të analizojë nëse kërkesa e tregut të punës për këto aftësi, mund të plotësohet me kapacitetet aktuale të aftësive, që tashmë janë në dispozicion në tregun e punës.



Vështirësi që mund të hasen gjatë shqyrtimit të ofertës mësimore në nivel kombëtar

- Informacioni i nevojshëm lidhur me ofertën mësimore të shkollave profesionale të tjera në nivel rajonal, mund të mos sigurohet në kohë.
- Informacioni i nevojshëm lidhur me kualifikimet kombëtare sipas skelet-kurrikulës së AKAFPK-së dhe/ose Udhëzuesit të AKAFPK-së për shkollat profesionale publike, mund të mos jenë përditësuar deri në muajin janar.

3.1.4 Analiza e gjurmimit të të diplomuarve

Në vijim të procesit të analizës së nevojave, koordinatori i gjurmimit sugjerohet që të analizojë të dhënat e punësimit të nxënësve të përfuara nga procesi i gjurmimit të vitit pararendës. Analiza e të dhënave të

punësimit, vlen të përqendrohet tek treguesit e punësimit sipas profileve apo drejtimeve të diplomimit, si dhe sektorëve të punësimit. Nëpërmjet analizës së këtyre të dhënave, koordinatori i gjurmimit, mund të informohet për ecurinë e të diplomuarve në tregun e punës, në veçanti për përputhshmërinë e vendit të punës me profilin profesional të përfutur në shkollë.

Analiza e të dhënave të gjurmimit siguron informacione si më poshtë:

- kërkesa e tregut të punës për drejtimet dhe profilet mësimore në lëvizim
- kërkesa e tregut të punës për rishikim dhe përshtatje të një drejtimi, profili apo programi pas të mesëm në lëvizim
- kërkesa e tregut e punës për një drejtim, profil apo program pas të mesëm të ri.

Analiza e gjurmimit të të diplomuarve në tregun e punës, rekomandohet të realizohet gjatë muajit janar.



Analiza e gjurmimit të të diplomuarve Shkolla "Hamdi Bushati"- Treguesit nxisin veprimin

Shkolla "Hamdi Bushati", Shkodër, iu bashkua S4J në fund të vitit 2017. Reputacioni i shkollës kishte rënë ndjeshëm. Në vitin akademik 2017-2018, vetëm 144 studentë u regjistruan në 3 drejtimet e studimit që shkolla ofronte.

Në 6 vitet e fundit, shkolla ofronte gjithsej 4 profile në 3 drejtimet e studimit. Oferta ishte statike. Bashkëpunimi me kompanitë ishte inekzistent. Mësimi praktik zhvillohej në laboratorët e shkollës.

Shkolla është përfshirë tashmë nga procese transformuese, një ndër të cilat është diversifikimi i ofertës. Ndërsa më shumë studentë po regjistroheshin, shkolla mund të aktivizonte më shumë profile në drejtimet që ofronte.

- *Bazuar në të dhënat e gjurmimit dhe inputeve nga kompanitë*, shkolla vendosi të ndalonte ofrimin e disa profileve dhe filloi të ofronte disa të tjera. Këta tregues nxitën veprimet për diversifikim.

Kjo solli shumë sfida të brendshme, pasi ishte e nevojshme të bëhej shumë punë për të zgjeruar ofertën. Duke filluar nga viti akademik 2018-2019, shkolla zgjeroi ofertën e saj me një program të ri, duke arritur kulmin në vitin akademik 2021-2022 me 8 profile aktive. Kjo krijoi mundësi më të mira për studentët, që të zgjedhin bazuar në preferencat e tyre, se në cilin profesion të specializohen bazuar në kërkesat e tregut.

- *Nga procesi i gjurmimit, pas diversifikimit të ofertës*, rezulton se 73%, nga grupi i diplomuar në 2021 janë të punësuar një vit pas diplomimit, një rritje prej 25 % nga niveli bazë (48%).

Lajmi më inkurajues lidhet me nivelin e të ardhurave për diplomuarit. Pjesa e diplomuarve që paguhen 35,001 lek në muaj është rritur gati 5 herë, nga 14%, për grupin e diplomuar në 2017, në 68% për grupin e diplomuar në 2021. Pjesa e atyre që marrin pagat më të larta, 50,001 lek në muaj, është rritur më shumë se 5 herë, nga 7% për grupin e diplomuar në 2017, në 39% për grupin e diplomuar në 2021.

3.1.5 Analiza e treguesve socio-ekonomikë

Analiza e treguesve socio-ekonomikë, sugjerohet si një analizë me rëndësi për të identifikuar shance për drejtime/profile të reja, apo sfida për ato ekzistueset, duke konsideruar trendet e viteve të fundit, të këtyre faktorëve në vendin tonë. Drejtuesi i shkollës profesionale, në bashkëpunim me koordinatorin e gjurmimit, sugjerohet të analizojnë tregues të ndryshëm socio-ekonomikë, që lidhen me nevojat dhe përparësitë e tregut të punës në rajonin përkatës. Këta tregues mund të përfshijnë:

- treguesit demografikë
- treguesit socialë dhe ekonomikë
- treguesit e ndryshimeve strukturore në ekonomi, etj.

Shqyrtimi i treguesve në fjalë (**Shtojca 4**), informon për mundësitë dhe sfidat e makromjedisit ku ndodhet shkolla profesionale, në veçanti sesi këto mundësi dhe sfida lidhen me ofertën mësimore në lëvizim. Trendet e reja të zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore kërkojnë që shkollat profesionale të jenë të hapura për diversifikimin e ofertës mësimore.

Treguesit socio-ekonomikë sigurohen nga burime të ndryshme zyrtare si për shembull AKPA, Zyra e Punës, INSTAT, etj. Analiza e treguesve me interes për diversifikimin e ofertës mësimore , paraqitet në një dokument informues, shoqëruar me sugjerime për ndryshime të nevojshme.

Ky hap rekomandohet të realizohet gjatë muajit janar.



Burime zyrtare për konsultim

AKPA: <https://www.puna.gov.al> | INSTAT: <https://www.instat.gov.al> | Zyra e Punës

- Për përfitim të të dhënave mund të angazhohet personi përgjegjës për statistikat në shkollën profesionale.
- Nëse shkolla profesionale, nuk ka kapacitetet e nevojshme për të siguruar treguesit zyrtarë, atëherë mund të drejtoheni tek AKPA dhe/ose Zyra e Punës.



Sfida prej ndryshimeve të shpejta të treguesve socio-ekonomikë

Referuar Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, rezulton:

- *Mospërputhje ndërmjet ofertës dhe kërkesës për aftësi në tregun shqiptar të punës.*

Këtë e konfirmojnë anketat e shumta me biznese të cilat pohojnë se disa nga aftësitë e munguara, janë pengesa kryesore për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Zhvillimi i kompetencave të nxëniet gjatë gjithë jetës dhe harmonizimi më i mirë i programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e aftësive, çfarë nxit procesin e diversifikimit të ofertës së shkollës profesionale.

- *Tkurrja e popullsisë dhe Emigrimi*

Ashtu si në shumë vende të Evropës, Shqipëria përballet me plakjen demografike të popullsisë së saj. Skenari i rritjes së mesme parashikon zvogëlim të popullsisë të moshës < 25 vjeç nga 882,903 që ishte në vitin 2021 në 788,160 në vitin 2026, si rezultat i uljes së lindjeve dhe migrimit. Kjo është një sfidë me të cilat do të përballen edhe në vijim shkollat profesionale, për të siguruar regjistrimet e nevojshme, apo për dinamikën që sjell emigrimi në ofertën e aftësive në tregun e punës.

- *Zhvillimet e shpejta teknologjike*

Këto zhvillime në mjedisin teknologjik, mund të sjellin kërkesa për aftësi profesionale të reja nga biznesi dhe industria, si rrjedhim edhe nevojën për diversifikim të vazhdueshëm të ofertës mësimore të shkollave profesionale. https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim-621_date-22.10.2021_Permiratimin-e-SKA-2021-2026.pdf

3.1.6 Analiza e praktikës profesionale në biznes

Një tjetër hap i nevojshëm për analizën e nevojave, *analiza e praktikës profesionale në biznes*, realizohet nga koordinatori për marrëdhëniet me biznesin në bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësit e departamenteve dhe me mbështetjen e mësimdhënësve të praktikës profesionale, si dhe të drejtuesit të shkollës profesionale. Gjatë muajit janar, ky grup pune sugjerohet të analizojë informacionin e mbledhur nga bizneset ku nxënësit kanë kryer praktikat profesionale. Gjetjet kryesore të analizës mund të paraqiten me shkrim në një proces-verbal si në shtojcë. (Shtojca 5).



Sugjerime për analizën e praktikës profesionale në biznes

Mbledhja dhe përpunimi i informacionit rreth bizneseve nëpërmjet praktikës profesionale të nxënësve, sugjerohet të realizohet në fund të vitit shkollor të vitit paraardhës, zakonisht në muajin qershor, pasi nxënësit kanë përfunduar praktikën profesionale.

3.1.7 Analiza e nevojave të kompanive

Në vijim të procesit të analizës së nevojave, sugjerohet të vijohet me analizën e detajuar të nevojave të kompanive. Informacioni i siguruar në këtë hap, është me rëndësi të lartë, pasi kompanitë prezantojnë kërkesën për aftësi profesionale, në tregun e punës. Gjatë periudhës janar – prill, koordinatori i kurrikulës, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin dhe koordinatori i orientimit në karrierë, me mbështetjen e drejtuesit të shkollës profesionale dhe të mësimdhënësve të praktikës profesionale, rekomandohet të analizojnë nevojat e kompanive për aftësi të ndryshme profesionale dhe punonjës të kualifikuar. Ky hap mund të përfshijë disa nën hapa, sic paraqiten në figurën më poshtë




Figura: Procesi i Analizës së nevojave të kompanive

(a) Përzgjedhja e kompanive

Koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, me mbështetjen e mësimdhënësve të praktikës profesionale dhe të drejtuesit të shkollës profesionale, mund të përzgjedhë nga baza e të dhënave të kompanive, një kampion të përshtatshëm për ta përfshirë në procesin e konsultimit (për një listë kriteresh përzgjedhjeje, shih **Shtojcën 6**. Përzgjedhja e kompanive, rekomandohet të kryhet gjatë muajve janar – shkurt.

(b) Përgatitja e pyetësorit

Në vijim, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, me mbështetjen e koordinorit të kurrikulës, të mësimdhënësve të praktikës profesionale dhe të drejtuesit të shkollës profesionale, vlen të përgatisë një

pyetësor për kompanitë e përzgjedhura për konsultim. Për këtë mund të konsultohet lista me pyetjet e lindura gjatë tryezave të dialogut të strukturuar (**Shtojca 7**). Pyetësi mund të përgatitet gjatë muajve janar – shkurt.



Sugjerime rreth identifikimit të nevojave të biznesit, bazuar në gjetje

- Pavarësisht se kompani specifike mund të sigurojnë informacionet bazë për aftësi të munguara në tregun e punës, rekomandohet që të identifikohen nevojat e sektorit privat përmes një analize gjithëpërfshirëse, të bazuar në gjetje dhe që shkojnë përtej rasteve sporadike, të kompanive specifike.
- Është thelbësore të validohen informacionet bazë nga sektori privat, përmes kërkimeve dhe analizave të bazuara në prova. Kështu për këtë qëllim, ka shembuj nga sektorët, ku janë përdorur intervistat/pyetësorët, për të siguruar informacionin për nevojat e sektorit për aftësi të munguara në tregun e punës.
- Procesit të hapjes së kualifikimit post të mesme, për Ndërmjetësues të Pasurive të Patundshme, i parapriu një studim i facilituar nga S4J, për analizimin e nevojave për aftësi të sektorit privat në sektorin e pasurive të patundshme, në përputhje me nivelet e kualifikimeve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në total, u zhvilluan 57 pyetësorë me përfaqësues të lartë të sektorit. Gjetjet treguan se ka një nevojë të lartë për agjentë të pasurive të patundshme, pasi industria do të vazhdojë të zgjerojë operacionet e saj në pesë vitet e ardhshme.

(c) Përgatitja për tryezën e dialogut me bizneset

Pas përgatitjes së pyetësorit, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës dhe të drejtuesit të shkollës profesionale, nis përgatitjet për organizimin e tryezës së dialogut me kompanitë e përzgjedhura. Tryeza e dialogut synojnë mbledhjen e informacionit në lidhje me interesat e kompanive për aftësi dhe kualifikime në drejtime, profile apo programe profesionale pas të mesmes. Tryezat e dialogut sugjerohet të organizohen në formatin e një fokus grupi, i cili përfaqëson një formë të hulumtimit cilësor ku pjesëmarrësit pyeten rreth opinioneve, perceptimeve dhe qëndrimeve të tyre përkundrejt një çështje specifike. Sugjerohet ky format, pasi tryezat e dialogut në konceptimin e tyre shkojnë përtej një fokusi, sic është parashikimi dhe vlerësimi i nevojës për aftësi. Ato synojnë të mundësojnë edhe koordinimim dhe partneritetin afat-gjatë midis ofruesve profesional dhe punëdhënësve, në një territor të caktuar.

Tiparet kryesore të tryezave të dialogut janë:

- Tryezat e dialogut, kanë karakter eksplorues, por duke ruajtur strukturimin e komunikimit në grup
- Tryezat e dialogut janë të përshtatshme për arritjen e konsensusit dhe sigurimin e ndërveprimit në grup, duke qenë se pjesëmarrësit inkurajohen jo vetëm të artikulojnë qëndrimet e tyre, por edhe të bashkëveprojnë me pjesëmarrësit e tjerë dhe facilitatorin.

Rezultatet e pritshme e tryezës së dialogut:

- Rritja e informimit të kompanive rreth ofertës së arsimit profesional;
- Rritja e ekspozimit dhe shkëmbimit të informacionit mes ofruesve dhe kompanive;
- Kontribuuimi në drejtim të identifikimit të nevojave për aftësi në plan afat-shkurtër dhe afat-mesëm në nivel rajonal;
- Krijimi i një mjedisi më mundësues për arritjen e diversifikimit të ofertës në rajon, në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- Rritja e besimit të ndërsjellë dhe angazhimit midis aktorëve ofrues dhe kërkues në tregun e punës.

Përgatitja për tryezën e dialogut sugjerohet të realizohet gjatë periudhës janar – shkurt.

(d) Organizimi i tryezës së dialogut me bizneset

Koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, me mbështetjen e koordinorit të kurrikulës dhe të drejtuesit të shkollës profesionale, organizon tryezën e dialogut mes shkollës dhe bizneseve të zonës. Për organizimin e tryezës së dialogut, mund të ndiqen sugjerimet si në **shtojcën 8**. Tryeza e dialogut me bizneset sugjerohet të organizohet brenda muajve mars – prill.



Shembuj të tryezave të dialogut me mbështetjen e S4J

- Gjatë periudhës tetor - nëntor 2019, S4J organizoi, 16 tryeza vendore të dialogut për zhvillimin e aftësive në 4 qarqe të vendit, Vlorë, Berat, Shkodër dhe Lezhë, me qëllimin për të diskutuar dhe reflektuar në drejtim të përditësimit të ofertës së shkollave profesionale, në këto qarqe, sipas nevojave të kompanive të pjesëmarrëse në tryezat e dialogut dhe që janë përfaqësuese të industrive të ndryshme. Tabela më poshtë paraqet industritë, pjesë e të cilave kanë qenë kompanitë pjesëmarrëse. Për organizimin e tryezave të dialogut në vijim, shkollat profesionale mund t'i referohen eksperiencës së tyre me të tilla organizime, si dhe dokumentit *“Guidë metodologjike për Tryezat Vendore të Dialogut për Zhvillimin e Aftësive”*, hartuar nga S4J.

Hoteleri/Njësi akomoduese	•Berat, Vlorë, Shkodër, Lezhë
Ndërtim/Mirëmbajtje	•Berat, Vlorë, Lezhë
Detari/Peshkim	•Vlorë, Lezhë
Përpunim ushqimor/Pije alkoolike	•Lezhë
TIK/Shërbime sigurie	•Shkodër
Shërbime financiare	•Shkodër
Përpunim druri dhe guri	•Berat
Tekstil/Galanteri	•Berat
Grupi BALFIN	•Vlorë
Bujtinat në Malësi të Madhe	•Shkodër

Figurë: Industritë pjesëmarrëse në tryezat e dialogut

(e) Dokumentimi i informacionit të përfutur nga bizneset dhe shqyrtimi i kërkesave të tyre për profesionale të caktuara

Pas organizimit të tryezave të dialogut, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, në bashkëpunim me koordinatorin e kurrikulës, sugjerohet të dokumentojnë informacionin e mbledhur nga pyetësorët si dhe nga diskutimi në tryezën e dialogut dhe të hartojnë një raport, shoqëruar me sugjerime/rekomandime, për diversifikimin e ofertës mësimore.

Mbështetur në këtë raport, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, në bashkëpunim me koordinatorin e kurrikulës, marrin në shqyrtim dhe identifikojnë kërkesat e bizneseve për aftësi profesionale specifike, për punonjësit e tyre.

Ky hap i fundit sugjerohet të realizohet në muajin prill.



Shembuj suksesi të tryzave të dialogut, për diversifikimin e ofertës

Industria rishikon kualifikimet - Rasti i Deloitte për profilin “Administrim Zyre”

Nevoja për përditësimin e kualifikimeve ekzistuese në profesionin e Administrimit zyre, është paraqitur nga Deloitte Albania and Kosovo, një ofrues shërbimesh për kompani në industri të ndryshme. Mungesa e

kurrikulave përkatëse është shndërruar në një sfidë për Deloitte, pasi individët me kualifikime të larta mund të punësohen, por nuk janë të interesuar të qëndrojnë, duke sjellë normë të lartë qarkullimi. Kjo situatë paraqet sfida lidhur me mbajtjen e stafit si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj palëve të treta.

Qëllimi përfundimtar i zhvillimit të kurrikulave, është të bëjë që oferta e arsimit profesional të jetë në përputhjen me kërkesën e tregut të punës. Disa kushte themelore duhet të plotësohen për të zhvilluar dhe zbatuar me sukses kualifikimet e udhëhequra nga industria. Këto hapa janë ndjekur në rastin e profilit “Administrim Zyre” dhe që paraqiten më poshtë:

- *A është i përshtatshëm kualifikimi i propozuar?* Kushti i parë që duhet plotësuar është validimi i nevojës për kualifikimin. Për këtë qëllim, u mbajt një tryezë dialogu me pjesëmarrjen e Deloitte, drejtuesve të SHTET dhe përfaqësuesve të AKAPFK, në tetor 2020. Deloitte e argumentoi nevojën duke shpjeguar se shumë nga klientët e saj, biznese me potenciale punësimi, artikulojnë rregullisht nevojën për pozicionin e administratorimit të zyrës, apo asistentit administrativ. Grupi ra dakord që kualifikimi i propozuar, ishte i përshtatshëm.
- *A mbështetet kualifikimi nga industria?* Kushti i dytë që duhet plotësuar është që kualifikimi të mbështetet nga një gamë e punëdhënësve dhe shkollave profesionale ofruese të tij. Hartëzimi i nevojave aktuale dhe të ardhshme për aftësi, të kompanive që punojnë në sektorët përkatës, e konfirmoi nevojën e tij dhe u vendos nga AKAPFK, që “Administrimi i Zyrës” të jetë një profil i ri, nën drejtimin e Ekonomisë dhe Biznesit (Niveli IV) dhe që kurrikula duhet të përditësohet me trendet më të fundit në sektor.



Diversifikimi i ofertës: Rasti i Shkollës “Kolin Gjoka”

Shkolla “Kolin Gjoka” në përpjekjet e saj për t'u transformuar në një institucion që ofron punëtorë të rinj të kualifikuar për kompanitë lokale, synonte të diversifikonte ofertën e saj duke hapur një drejtim të ri në përpunimin e ushqimeve.

Në dhjetor 2016, shkolla nënshkroi Memorandume Mirëkuptimi me gjashtë kompani lokale, duke përfshirë përfaqësues të sektorit të turizmit dhe mikëpritjes në rajon, si Altin Prenga, bashkëthemelues dhe menaxher i Mrizi i Zanave, dhe Alfred Marku, pronar dhe menaxher i Rapsodia, të cilët mbështetën idenë për një program të ri në përpunimin e ushqimeve.

Në nëntor 2018, u mbajt një workshop si fazë e hershme e tryezave të dialogut që do të zhvilloheshin më vonë, që përfshinte 13 kompani të rajonit të përpunimit të ushqimeve, drejtuesin e zyrës së punës, një specialist nga AKAPFK si dhe drejtuesit dhe mësuesit e shkollës “Kolin Gjoka”.

Ky proces dialogimi, bashkëpunimi i aktorëve të rëndësishëm të sektorit, arriti të:

- *Identifikojë Mangësitë/ nevojat në aftësi për sektorin:* Procesi ndihmoi në përcaktimin e boshllëqeve në aftësi në sektorin e përpunimit të ushqimeve.
- *Rrisë Angazhimet e Kompanive për:*
 - Promovimin e drejtimit të ri të teknologjisë së ushqimeve për të inkurajuar regjistrimin e studentëve.
 - Përshtatjen e kurrikulës së shkollës me nevojat e industrisë.
 - Kontributin në trajnimin e mësuesve.
 - Sigurimin e vendeve të praktikës për studentët që do të regjistroheshin.

Një dokument që përshkruante këto angazhime u nënshkrua nga të gjitha kompanitë e pranishme, i cili më pas u përdor për të mbështetur propozimin për hapjen e drejtimit të ri.

Pas workshop-it, u përgatit një raport teknik dhe u paraqit në bordin e menaxhimit të shkollës. Bordi miratoi propozimin dhe dorëzoi një kërkesë formale në ministrinë përkatëse për drejtimin e ri “Teknologjia e Ushqimeve”. Ministria e miratoi drejtimi i ri u hap në Shtator 2019.

Suksesi i këtij projekti, ka çuar në zgjerimin e përpjekjeve të S4J për të mbështetur mbi 30 ofrues në katër rajone të Shqipërisë, duke organizuar workshop-e dhe tryeza dialogu, për të nxitur dialog të strukturuar, ndërmjet institucioneve të arsimit profesional dhe industrisë.



Vështirësi që mund të hasen gjatë analizës së nevojave të kompanive

- Realizimi i tryezave efektive, mbetet sfidë, për arsye se bizneset nuk janë gjithnjë aktivë, të angazhuar dhe produktivë në ofrimin e informacionit, në përputhje me qëllimin e këtyre tryezave të dialogut. Sugjerohet zgjedhja e kujdesshme e kompanive, duke marrë në konsideratë nivelin e tyre të angazhimit dhe vullnetin për t’u bërë pjesë e këtyre procesve.
- Sigurimi i informacionit të mjaftueshëm apo dhe të saktë në lidhje me kërkesat e bizneseve të zonës për aftësi të caktuara profesionale dhe nevojës për punonjës të kualifikuar, është një sfidë, për shkollat profesionale. Informacioni i pamjaftueshëm ose i pasaktë mund të shpjerë në identifikim të gabuar të nevojave dhe rrjedhimisht të dëmtojë bashkërendimin e punës së shkollave profesionale me bizneset.
- Nga përvojat e mëparshme pranohet se për shkollat profesionale, mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve, mund të jetë veçanërisht e vështirë. Një mundësi për tejkalimin e kësaj vështirësie është planifikimi paraprak i mënyrave më të përshtatshme të sigurimit të informacionit në përputhje me

mundësitë e shkollave profesionale . Informacion shtesë, mund të sigurohet edhe nëpërmjet kontakteve individuale të stafit mësimor me bizneset, në raste kur personat njihen personalisht.

- Në rastin e hapjes së drejtimeve të reja, organizimi i tryezat të dialogut ne muajin mars-prill mund të konsiderohet një proces i vonë, duke qenë se hapja e drejtimeve të reja impakton, burimet njerëzore dhe ato miratohen mbi bazë viti fiskal dhe jo viti shkollor. Për të tejkaluar këtë, sugjerohet organizimi i tryezave të dialogut për drejtimet e reja, të planifikohen të zhvillohen së paku, në nëntorin e vitit paraardhës.



Sugjerime për analizën e nevojave të kompanive

- Informacioni i përftuar nga tryeza e dialogut me bizneset dhe pyetëtori sugjerohet të konsultohet edhe me dhomat ekonomike si dhe/apo shoqatat e biznesit. Dhomat Ekonomike apo shoqatat e biznesit, mund të plotësojnë informacionin, por edhe mund ta vlerësojnë atë profesionalisht, duke pasur një qasje më afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse.
- Sugjerohet që për analizën e nevojave, grupi i punës të përfshijë sa më shumë biznese të jetë e mundur. Numri i lartë i bizneseve të konsultuara forcon bashkëpunimin e shkollës me tregun e punës dhe siguron saktësinë e informacionit mbi nevojat e kompanive, për aftësi të ndryshme profesionale dhe punonjës të kualifikuar.
- Për organizimin e tryezës së dialogut, grupi i punës mund t'i referohet modelit të organizimit të tryezave vendore të dialogut të strukturuar të projektit “Aftësi për punë”.

Dialogu vlen të fokusohet në pikat e mëposhtme:

- vlerësim i ofertës në lëvrin përkundrejt kërkesave të tregut të punës
- identifikimi i aftësive të munguara sipas industrive të caktuara
- vlerësimi i gatishmërisë së kompanive për t'u angazhuar në diversifikimin dhe lëvrin e ofertës mësimore.

- *Qasja Bashkëpunuese:* Partneriteti ndërmjet shkollës dhe bizneseve lokale rezultoi kyç në identifikimin e nevojave të sektorit dhe zhvillimin e një kurrkule që përmbush ato nevoja.
- *Angazhimi i Industrisë:* Angazhimi i liderëve të industrisë, rezultoi i rëndësishëm për suksesin e lançimit dhe zbatimit të programit të ri, sic ishte rasti i SHTET dhe shkollës “Kolin Gjoka”.

- *Procesi i Strukturuar:* Tryezat e dialogut dhe proceset formale të mëvonshme siguruan që drejtimi i ri, sic ishte rasti i SHTET dhe i shkollës “Kolin Gjoka”, të ishte i mbështetur mirë nga industria dhe të përshtatej me nevojat e tregut.

3.1.8 Analiza e këndvështrimit të nxënësve

Në hapin fundit të fazës së parë, *analizës së nevojave*, koordinatori i orientimit në karrierë, me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës, sugjerohet të analizojë këndvështrimin e nxënësve lidhur me zgjedhjen e profilit. Analiza mund të fokusohet në aspekte si arsytet e zgjedhjes së profilit, mundësitë e punësimit sipas profileve, etj. Ky hap mund të realizohet nëpërmjet nën hapave si në vijim:

- (a) Organizmi i një sesioni informues me nxënësit për zgjedhjen e profilit dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të shkollës.

Koordinatori i orientimit të karrierës, sugjerohet të organizojë një sesion informues për ofertën mësimore të shkollës profesionale. Informimi mund të fokusohet në profilet që ofron shkolla dhe mundësitë e punësimit sipas profileve, përfshi nivelet e pagesave që ofron tregu i punës (për më shumë, shih **Shtojcën 9**. Sesioni informues sugjerohet të organizohet në muajin mars.



Sugjerime për sesionet informuese për zgjedhjen e profilit

Informimi i nxënësve për zgjedhjen e profilit është shumë i rëndësishëm dhe nevojitet të jetë sa më efektiv. Sugjerohet që në sesionet informuese të jepet informacion rreth:

- Përshkrimeve të profesioneve/punëve që priten të kryejnë nxënësit pas diplomimit
- Njohurive që kërkohen për një punësim të mundshëm
- Pagave mesatare fillestare të këtyre profesioneve në tregun e punës
- Punëdhënësve të mundshëm
- Të ardhmes së këtyre profesioneve

Profili ‘Guidë turistike’- shkolla “Hamdi Bushati”

Nga eksperiencia e shkollës “Hamdi Bushati”, shkolla informon nxënësit nëpërmjet seksioni informues, për t’i orientuar ata drejt zgjedhjes së profilit. Guida për zgjedhjen e profilit, është në dispozicion të nxënësve

dhe ofron informacion për procedurën që ndiqet si dhe informacion për profesionin. Në vijim një infomacion për profilin 'Guidë turistike', pranë kësaj shkolle.

- **Përshkrim i profesionit.** *Guidat turistike punojnë në sektorin e udhëtimeve. Ata organizojnë ture informuese për grupet e vizitorëve. Guidat janë ekspertë në historinë e vendit. Ata u japin turistëve informacione interesante rreth bukurive natyrore, vendeve historike, muzeve, vendeve piktoreske dhe destinacioneve të tjera të udhëtimit. Guidat turistike punësohen nga zyrat e vizitorëve, apo kompanitë e udhëtimit dhe janë zakonisht banorë të rajonit në të cilin punojnë.*

Punëdhënësit e mundshëm: *Fillimisht do të punoni si guidë me një agjenci turistike dhe, me fitimin e eksperiencës, mund të punoni si guidë e pavaruar vetëm, ose me agjenci, apo kompani të ndryshme.*

Paga mesatare fillestare: 47000 lekë bruto

Aftësitë dhe interesat kryesore të një guide turistike janë:

- Aftësi për të komunikuar mirë me grupe të mëdha
- Kujtesë e mirë dhe aftësi rrëfyese
- Pasion për punën
- Fleksibilitet dhe përshtatshmëri sipas kërkesave të grupit apo individëve të veçantë
- Përpikmëri në orare
- Ndjenjë humori

(b) Përgatitja dhe shpërndarja e pyetësorit për nxënësit e klasës së 11-të lidhur me përzgjedhjen e profilit

Koordinatori i orientimit në karrierë, me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës, sugjerohet të përgatisë një pyetësor për nxënësit e klasës së 11-të, të cilin mund t'ia shpërndajë nxënësve pas sesionit të informimit (**Shtojca 10**). Pyetësori mbledh informacion për preferencat e nxënësve të klasës së 11-të, për profilet që duan të ndjekin dhe arsyet e zgjedhjes së këtyre profileve.

Përgatitja dhe shpërndarja e pyetësorit rekomandohet të realizohet në muajin prill.



Sfidat dhe sugjerime për këndvështrimin e nxënësve
Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

- Nga eksperiencia e shkollës Teknike-Ekonomike Tiranë, gjatë promovimit të ofertës së shkollës, vihet re se profili Tekstil Konfeksion nuk zgjidhet, sepse nxënësit nuk e njohin si term dhe frenohen për ta zgjedhur. Përfaqësues të shkollës sugjerojnë se duhet një emërtim më koherent dhe më atraktiv për këtë profil.
- Sesioni informimit fillon në klasën e 10-të, në javën e mirëseardhjes, prezantohet njësia e zhvillimit, çfarë drejtime/profile ofron shkolla, cilat janë mundësitë e punësimit etj.
- Në klasën e 11, SHTET zhvillon edhe një vetëvlerësim të nxënësve, për të identifikuar cilat janë aftësitë e tyre. Vlerësohet praktika e përfshirjes edhe psikologut, në formën e bashkëbisedimit të tij me nxënësit, që është ndjekur në disa raste në SHTET, për të identifikuar më mirë kërkesat, interesat, prirjet e nxënësve që mund të ndikojnë aftësitë e tyre në profilin e ardhshëm.
- Në përfundim zhvillohet një pyetësor për nxënësit në fund të muajit maj. Përfaqësues të SHTET sugjerojnë shtimin edhe të një pyetje në pyetësorin për nxënësit, lidhur me profile të reja, që ata mund të sugjerojnë për të ardhmen.

(c) Analiza e përgjigjeve të pyetësorit dhe dokumentimi i gjetjeve

Pas shpërndarjes së pyetësorit, koordinatori i orientimit në karrierë, me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës, sugjerohet të analizojnë përfundimet. Synimi i analizës është të informojë për profilet që nxënësit preferojnë, cilat profile preferohen më pak e cilat më shumë dhe pse. Gjetjet rekomandohet të dokumentohen në një raport me shkrim (**Shtojca 11**).

Analiza e këndvështrimit të nxënësve sugjerohet të realizohet gjatë muajit maj.



Sugjerime për analizën e këndvështrimit të nxënësve

- *Informimi efektiv i nxënësve për zgjedhjen e profilit.*

Dhënia e informacioneve të plota dhe të sakta ndihmon drejt një procesi të suksesshëm profilizimi. Ky proces në shkollën “Hamdi Bushati” zhvillohet nëpërmjet koordinatorit të orientimit për karrierë, koordinatorit të zhvillimit të kurrikulave, si dhe mësimitdhënës të kualifikimit përkatës. Këto aktorë sigurohen për dhënien e informacioneve të sakta në lidhje me:

- Programin e kualifikimeve profesionale
- Mundësitë e realizimit të praktikave profesionale dhe prezantim i bizneseve
- Mundësitë e punësimit
- Raste suksesi

Mbështetur në eksperiencën e shkollës “Hamdi Bushati”, mësuesit gjatë procesit të profilizimit, kanë identifikuar se nxënësit e klasave të 11-ta, preferojnë të përzgjedhin profilin Kuzhinë – Pasticeri, sepse mendojnë se po të zgjedhin profile të tjera, nuk do të kenë mundësi të punojnë si kuzhinierë, ndërkohë që ky perceptim nuk është i saktë.

Ata sugjerojnë që shkollat të informojnë sa më qartë nxënësit, lidhur me mundësitë e tyre të punësimit. Sipas eksperiencës së tyre, në këtë proces është me shumë vlerë, që në informimin/shpjegimin, të përfshihen edhe specialistë të ftuar nga biznesi. Kjo do të ndihmonte për një proces të suksesshëm profilizimi për shkollën, si dhe një orientim më të plotë dhe më të qartë për nxënësit, për profilet dhe mundësitë e tyre të punësimit.

- *Plotësimi i pyetësorit për zgjedhjen e profilit në manyrë sa më racionale dhe objektive, mbetet ende një sfidë.*

Mbështetur në eksperiencën e disa shkollave, si “Kolin Gjoka”, “Hamdi Bushati”, SHTET, sugjerohet që mësuesi t’iu shpjegojë nxënësve për rëndësinë e zgjedhjes së një profili që përkon me interesat, vlerat dhe prirjet e tyre, si dhe me mundësitë më të mira të punësimit apo të ardhurave më të larta në të ardhmen. Informimi, komunikimi, diskutimi rreth dilemave që ata mund të kenë, është i rëndësishëm në cilësinë e plotësimit të pyetësorit dhe të uljes së subjektivizmave në plotësimin e tij. Për këtë mund t’i referoheni edhe manualit për përzgjedhjen e profilit.

- *Në faqen e internetit <https://dip.skillsforjobs.al/> nxënësit mund të gjejnë informacion të pasur lidhur me profesione të ndryshme, të përgatitur nga projekti S4J.*
- *Rishikimi dhe përmirësimi i pyetësorit të nxënësve.*

Nga diskutimet me përfaqësues të shkollave profesionale, që tashmë kanë krijuar eksperiencë me këtë proces, (Shkolla Tregtare Vlorë, Shkolla “Kolin Gjoka”, etj), sugjerohet rishikimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i pyetësorit për nxënësit, duke përfshirë elementë të rinj, nisur nga feedback i marrë nga tryezat e dialogut me kompanitë, që reflekton edhe dinamizmin e kërkesës së tregut për aftësi profesionale të ndryshme. Kjo mund të informojë më mirë nxënësit për profilet për të cilat ka më shumë nevojë tregu aktual, duke i orientuar ata drejt një zgjedhje më racionale të profilit të tyre.

3.1.9 Përgatitja dhe diskutimi i raportit të gjetjeve

Etapa përmbyllëse e analizës së nevojave konsiston në përgatitjen dhe diskutimin e raportit përmbledhës të gjetjeve. Ky raport duhet të përmbajë të dhënat e mbledhura dhe analizat e kryera gjatë gjithë fazës, duke përfshirë informacionin mbi ofertën mësimore të shkollës, ofertën mësimore në nivel kombëtar, rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve, treguesit socio-ekonomikë, praktikën profesionale në biznes, nevojat e kompanive, si dhe këndvështrimin e nxënësve.

Raporti duhet të jetë i qartë, i strukturuar dhe i bazuar në të dhëna, për të siguruar që vendimmarrja për diversifikimin e ofertës mësimore mbështetet në një analizë të besueshme. Pasi të përgatitet, raporti i paraqitet Bordit Drejtues të Shkollës Profesionale (**Shtojca 12**). Kjo etapë synon të sigurojë konsultimin e raportit të gjetjeve, si dhe të vendosë bazat për fazën e ardhshme, marrjen e vendimit.

Rast suksesi për fazën e parë të analizës së nevojave



Shembull suksesi i fazës së parë - Analizës së nevojave

Shembulli në vijim eksploron procesin e ndjekur, për hapjen e *Ndërmjetësit të Pasurive të Patundshme* në sistemin e arsimit profesional, si një program pas-shkollor, pranë SHTET - Shkolla Teknike Ekonomike, Tiranë. Ky proces është udhëhequr nga analiza e nevojave të tregut të punës.

Biznesi i organizuar në sektorin e pasurive të patundshme në Shqipëri, mbështeti zhvillimin e aftësive në nivelin kombëtar, përmes punës së përbashkët dhe angazhimit me Shkollën Teknike-Ekonomike në Tiranë dhe AKAPFK, për hartimin e një programi pas-shkollor në fushën e pasurive të patundshme.

Hapat e ndjekur në këtë proces paraqiten në vijim:

- *Krijimi i kanaleve të strukturuar dhe të qëndrueshme të bashkëpunimit me sektorin privat.* Mënyra më efektive për sektorin privat për të komunikuar nevojat e tij me sistemin arsimor është përmes marrëdhënieve të strukturuar dhe të qëndrueshme me ofruesit arsimorë. Kështu shkolla Teknike-Ekonomike në Tiranë, SHTET, kishte një bashkëpunim shumë të mirë me përfaqësues të sektorit privat nga sektori i pasurive të patundshme, REMAX, për të ofruar mësim në vendin e punës, për studentët e profilit "Tregti" në drejtimin e profesionit "Ekonomi-Biznes". Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, ata identifikuan disa nevoja parësore për profesione në sektorin e pasurive të patundshme, siç është nevoja për agjentët e pasurive të patundshme. Megjithatë pasuritë e patundshme përfaqësojnë një nga sektorët më të rëndësishëm në ekonomi, oferta arsimore dhe e trajnimeve për të punuar në këtë sektor, nuk ishte e plotë.
- *Identifikimi i nevojave të sektorit privat përmes një analize gjithëpërfshirëse të bazuar në prova.* SAJ e lehtësoi këtë proces, duke ndërmarrë një studim për analizimin e nevojave për aftësi në sektorin e

pasurive të patundshme, në përputhje me nivelet e kualifikimeve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Për këtë qëllim, u zhvilluan 57 pyetësorë me përfaqësues të lartë të sektorit. Gjetjet treguan se ka një nevojë të menjëhershme për agjentë të pasurive të patundshme, pasi industria parashikohet të vazhdojë të zgjerojë operacionet e saj në pesë vitet e ardhshme. Rezultatet treguan se agjenti i pasurive të patundshme duhet të marrë një “trajnim ndërdisiplinor” dhe të ketë një arsimim profesional, që nuk ofrohej deri atëherë.

- *Përfshirja e hershme e punëdhënësve në procesin e diversifikimit të ofertës nëpërmjet tryezave të dialogut, ndihmojnë për sigurimin e angazhimit të suksesshëm dhe lehtëson mbledhjen e informacionit dhe inputeve të rëndësishme.* Një ndër rastet është edhe organizimi i tryezës së dialogut mes SHTET, Shoqatës Kombëtare të Pasurive të Patundshme në Shqipëri, AKAFPK dhe bizneseve të sektorit të pasurive të patundshme, me facilitimin e S4J, në prill 2022. Gjatë vitit 2021, Shoqata Kombëtare e Pasurive të Patundshme në Shqipëri, kishte konsoliduar strukturat e saj organizative të brendshme dhe operatorët kryesorë të sektorit ishin tashmë anëtarë të shoqatës. Nga ana tjetër, në përputhje me ligjin nr. 9/2022 “Për profesionin e ndërmjetësve të pasurive të patundshme” të datës 27.01.2022, profesioni i ndërmjetësit të pasurive të patundshme, bëhet një profesion i rregulluar që mund të ushtrohet vetëm nga personat e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë. Ligji i detyron kandidatët për ndërmjetës të pasurive të patundshme, të kalojnë një program trajnimi të detyrueshëm dhe të kenë të paktën një arsim të plotë të mesëm. Në këtë kontekst, në bashkëpunim me AKAFPK dhe Shkollën Teknike-Ekonomike, S4J organizoi një tryezë dialogu, për të validuar rekomandimet e studimit, ku ishin përfshirë 57 aktorëve të sektorit të pasurive të patundshme dhe për të nxitur mundësitë e bashkëpunimit për plotësimin e nevojave për aftësi të këtij sektori.

Rekomandimi kryesor i studimit të fazës së mëparshme të procesit, ishte nevoja për hartimin e një kualifikimi pas të mesme, që do të plotësonte nevojat për aftësi të këtij sektori. AKPFKA dhe përfaqësuesit e sektorit në këtë tryezë validuan këtë nevojë, diskutuan rreth plotësimit të saj, si dhe u angazhuan të kontribuojnë me ekspertë nga sektori privat në procesin e zhvillimit të kualifikimeve dhe më pas në ngritjen e vetëdijes për kualifikimin dhe mësimin në vendin e punës.

- *Angazhimi i sektorit privat në procesin e zhvillimit të kualifikimeve* Përfshirja e sektorit privat në procesin e zhvillimit të kualifikimeve, ndihmon për të siguruar që përmbajtja t'i përkasë praktikave aktuale të sektorit dhe të jetë e adaptuar për të përmbushur nevojat e sektorit privat. Grupi i punës i përbërë nga ekspertë të lëndëve nga sektori privat dhe shkollat profesionale, nisën në qershor 2022 hartimin e dokumenteve të kualifikimit. Nën moderimin e AKPFKA, ekspertët e industrisë punuan për zhvillimin e standardeve profesionale, përshkrimit të kualifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës për të profesionin e ri të Ndërmjetësit të Pasurive të Patundshme në sistemin e arsimit profesional, si një program pas-shkollor.

Në përfundim, kalimi drejt zhvillimit të aftësive të drejtuara nga kërkesa dhe diversifikimi i ofertës, duhet të arrihet përmes angazhimit të të gjithë aktorëve të sistemit. Megjithatë, ndonëse nevojat individuale të punëdhënësve mund të mos artikulojnë aq qartë dhe rregullisht, shoqatat e biznesit mund të ndihmojnë duke identifikuar nevojat aktuale dhe të ardhshme për aftësi të anëtarësisë së tyre. Kjo lloj

gasje e ndjekur në këtë rast sukcesi të diversifikimit të ofertës në SHTET, mund të adaptohet, për diversifikimin e ofertës së shkollave të tjera profesionale nisur nga analiza e nevojave të tregut për zhvillimin e aftësive të munguara edhe në sektorë të tjerë.

3.2 MARRJA E VENDIMIT

Faza e dytë e procesit të diversifikimit të ofertës, *marrja e vendimit*, është një fazë e rëndësishme ku shkolla bën zgjedhje të informuara për rezultate sa më të larta. Kjo fazë ka për synim marrjen e vendimit për zbatimin e ndryshimeve të nevojshme në ofertën mësimore të identifikuar gjatë fazës së parë, *analizës së nevojave*. Marrja e vendimit kryhet gjatë një periudhe 3-mujore, duke nisur nga maji e deri në korrik. Përrjashtim bën hapi i tretë, *në rast çeljeje të një kualifikimi (drejtimi/profili) profesional të ri*, i cili mund të zgjasë edhe deri në muajin dhjetor. Vendimi për diversifikimin e ofertës mësimore është mirë të merret pasi grupi i punës të ketë analizuar me kujdes kapacitetet profesionale dhe materiale të shkollës.

Në rastin kur merret vendim për çeljen e një (ose dhe më shumë) kualifikimi profesional të ri, nevojitet që shkolla t'i dërgojë një kërkesë me shkrim Ministrisë së linjës. Në mbështetje të kërkesës, vlen të dërgohen edhe disa dokumente si miratimi i Bordit Drejtues të shkollës, angazhimi i biznesit për ofrimin e kualifikimit profesional të ri, si dhe një relacion teknik bazuar në analizën e nevojave dhe të mundësive të shkollës për çeljen e kualifikimit në fjalë. Në rastin kur shkolla vendos të ofrojë një (ose dhe më shumë) modul me zgjedhje të detyruar përveç atyre që përmban skeletkurrikula përkatëse, sipas Udhëzimeve të AKAFPK-së, drejtoria e shkollës i propozon në rrugë zyrtare Sektorit të Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse pranë AKAFPK-së ofrimin e modulit/eve në fjalë.



Personat përgjegjës për zbatimin e fazës së dytë të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore, *marrjen e vendimit*, janë:

- a. drejtuesi i shkollës
- b. koordinatori i kurrikulës
- c. koordinatori i marrëdhënieve me biznesin
- d. koordinatori i gjurmimit
- e. personi përgjegjës për financat

Në vijim paraqitet një përshkrim i detajuar i hapave të punës, përfshirë kontributet e personave të angazhuar në këtë fazë.

3.2.1 Analiza e kapaciteteve për lëvrimin cilësor të ofertës së re mësimore

Para se të merret vendimi për diversifikimin e ofertës mësimore, vlen që grupi i punës të analizojë kapacitetet e ndryshme të shkollës për lëvrimin cilësor të ofertës së re (shkurt, *analiza e kapaciteteve*). Kjo ndihmon që vendimmarrja të jetë e mirë-informuar, bazuar në mundësitë reale të shkollës. Për këtë, koordinatori i kurrikulës, me mbështetjen e drejtuesit të shkollës dhe të personit përgjegjës për financat, verifikon përmbushjen e kapaciteteve të shkollës në 3 drejtime:

- (a) kapacitetet profesionale të stafit mësimor (**Shtojca 13**)
- (b) kapacitetet infrastrukturore të shkollës
- (c) kapacitetet materiale të shkollës

Gjatë këtij hapi, koordinatori i kurrikulës është mirë të ketë parasysh edhe mundësitë për realizimin e praktikës profesionale në bizneset e zonës.

Në përfundim, koordinatori i kurrikulës përgatit një pasqyrë me gjetjet e dala nga analiza, ku paraqiten kapacitetet profesionale dhe materiale të shkollës për lëvrimin e ofertës së re.

Sugjerohet që analiza e kapaciteteve profesionale dhe materiale të shkollës të kryhet brenda muajit maj.



Sugjerime për analizën e kapaciteteve për lëvrimin cilësor të ofertës

Analiza e kapaciteteve është mirë të kryhet në konsultim të vazhdueshëm me stafin mësimor dhe bizneset e zonës në mënyrë që të përftohet informacionin më i fundit në lidhje me mundësitë për lëvrimin e ofertës së re mësimore.



Vështirësi që mund të hasen gjatë analizës së kapaciteteve për lëvrimin cilësor të ofertës

- Përpos vlerësimit të kapaciteteve materiale të shkollës, koordinatori i kurrikulës, me mbështetjen e drejtuesit të shkollës dhe të personit përgjegjës për financat, vlen të marrë parasysh vonesa të mundshme në furnizimin e shkollës me bazën materiale të nevojshme për lëvrimin cilësor të ofertës së re mësimore.
- Vonesa të mundshme vlen të parashikohen edhe për përmirësimin apo përshtatjen e infrastrukturës së shkollës për lëvrimin e ofertës së re mësimore.
- Një nga sfidat mund të jetë edhe vullneti profesional i mësuesve për të kontribuar në diversifikimin e ofertës mësimore. Në raste të tilla, duke konsideruar rëndësinë e mësuesve në proces, vlen të orientohet përfshirja e tyre, nëpërmjet komunikimit dhe diskutimit të vazhdueshëm me mësuesit për të kuptuar nga vjen rezistenca dhe për t'a adresuar atë.

3.2.2 Marrja e vendimit për ofertën e re mësimore

Bazuar në analizën e kapaciteteve të shkollës për lëvrimin cilësor të ofertës së re mësimore, në muajin prill, drejtuesi i shkollës mund të marrë vendimin për ofertën e re të vitit mësimor në vijim. Oferta e re mësimore i paraqitet për miratim Bordit Drejtues të shkollës (**Shtojca 14**), shoqëruar me një relacion teknik në mbështetje të kërkesës. Relacioni teknik paraqet përmbledhtazi përfundimet e analizës së nevojave dhe të mundësive të shkollës për ndryshimet e synuara në ofertën mësimore (për përgatitjen e relacionit teknik, shih udhëzimet më poshtë). Sugjerohet që, brenda muajit maj, shkolla të organizojë një takim me Bordin Drejtues, ku të merret në shqyrtim dhe më pas të miratohet oferta e re mësimore. Për organizimin e takimit mund të ndihmojë personi përgjegjës për protokollin. Ai ose ajo mund të shpërndajë paraprakisht programin (**Shtojca 15**) dhe, pas takimit, të dokumentojë me anë të një proces-verbali diskutimet kryesore dhe vendimet e marra në takim (**Shtojca 16**).

3.2.3 Në rast çeljeje të një kualifikimi (drejtimi/profili) profesional të ri

Në rast vendimi për çeljen e një kualifikimi (drejtimi/profili) profesional të ri, drejtorja e shkollës harton një kërkesë drejtuar ministrisë së linjës (për një model kërkesë, shih **Shtojcën 17**). Kërkesa mund të përgatitet brenda muajit maj, menjëherë pas mbledhjes me përfaqësuesit e Bordit Drejtues. Gjatë muajve maj – dhjetor, drejtuesi i shkollës ndjek procesin e shqyrtimit të kërkesës nga ministria e linjës.

Për sqarim dhe në mbështetje të kërkesës, vlen të dërgohen edhe dokumentet e mëposhtëm që paraqesin:

(a) miratimin e Bordit Drejtues të shkollës (Shtojca 14)

Ky dokument i drejtohet anëtarëve të Bordit Drejtues të shkollës në formë kërkesë për miratim të çeljes së një kualifikimi profesional të ri (drejtim ose profil). Aty paraqiten burimet në të cilat mbështetet kërkesa, si për shembull analiza e nevojave të tregut të punës, kapacitetet profesionale dhe materiale/infrastrukturore të shkollës, të dhënat e Zyrës së Punës, etj. Kërkesa parashtrohet nga drejtuesi i shkollës dhe kryetari i bordit dhe miratohet me firmën e të gjithë anëtarëve të Bordit.

(b) angazhimin e biznesit në mbështetje të kualifikimit të ri (**Shtojca 18**)

Ky dokument paraqet vullnetin e mirë dhe gadishmërinë e bizneseve të ndryshme për bashkëpunimin e nevojshëm me shkollën për çeljen e kualifikimit profesional të ri. Përfaqësuesit e bizneseve konfirmojnë nevojën e tregut të punës për punonjës të kualifikimit në fjalë si dhe angazhohen të mirëpresin nxënës për praktikën profesionale dhe të caktojnë lektorë sipas nevojave të shkollës. Në fund, dokumenti firmoset nga të gjithë përfaqësuesit e biznesit.



Shembull i praktikës së mirë të bashkëpunimit shkollë – sektor privat

'Dita e hapur' në shkollën profesionale teknike-elektrike 'Gjergj Canco' në Tiranë , organizuar më 28 maj 2018, përkoi me 35 vjetorin e krijimit të kësaj shkolle. Në aktivitet morën pjesë disa ish nxënës, si ish Ministri Blendi Klosi, nënkryetari i Bashkisë së Tiranës Andi Seferi, dhe në atë kohë Kryetar i Bordit të Shkollës dhe themeluesi i duapune.com dhe DM Consulting Services Dritan Mezini. Aktiviteti shënoi nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes shkollës dhe biznesit të parë të përfshirë në skemën e praktikave profesionale. Përgjatë një viti shkollor, 2017 – 2018, mësuesit përgjegjës për marrëdhëniet me biznesin, së bashku me stafin e projektit, identifikuan, u takuan dhe arritën të firmosin marrëveshje me 297 kompani që do të mirëpresin 716 praktikantë në drejtimet TIK, elektrikë dhe elektronikë. Shkolla vijon të zgjerojë rrjetin e partnerëve, në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë praktikën në biznes.

- (c) një relacion teknik bazuar në analizën e nevojave dhe të mundësive të shkollës për çeljen e kualifikimit profesional të ri

Relacioni teknik përgatitet nga koordinatoresha e Njësisë së Zhvillimit. Në të argumentohet me detaje kërkesa për hapjen e një kualifikimi profesional të ri. Më poshtë sugjerohet një model i thjeshtë se si të shkruhet një relacion teknik.



Çfarë përmban një relacion teknik?

Hyrje

Në fillim të relacionit, mund të përshkruani shkurtimisht qëllimin e tij, për shembull: 'Ky relacion teknik shtjellon kërkesën për hapjen e kualifikimit profesional _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____, në vitin shkollor _____, në shkollën profesionale _____ në _____.'

Të dhëna mbi institucionin

Pas prezantimit të lëndës, mund të paraqisni të dhëna mbi institucionin si profili i shkollës, misioni, karakteristika të veçanta të punës së shkollës, si për shembull theksimi i aftësive të caktuara, përdorimi i metodologjike ndërvepruese në procesin mësimor, etj. Këtu vlen të përfshini edhe të dhënat më të fundit rreth punësimit të nxënësve, të përfuara nga gjurmimi i të diplomuarve në shkollën tuaj. Të tjera të dhëna mund të jenë drejtimet që ofron shkolla, marrëdhëniet me bizneset e zonës, si për shembull numri i marrëveshjeve me bizneset, si dhe me institucione të tjera partnere, si për shembull Zyra e Punës, Bashkia/Prefektura, etj.

Analiza e tregut të punës

Këtu mund të paraqisni shkurtimisht analizën e tregut të punës me anë të së cilës u identifikua nevoja për çeljen e një kualifikimi profesional të ri. Aty mund të përshkruani sesi gjatë procesit të diversifikimit të ofertës mësimore, shkolla juaj identifikoi nevojën e tregut rajonal për punonjës në një fushë të caktuar. Këtu mund të përmendni edhe komunikimin me biznese të ndryshme partnere të shkollës dhe/ose bashkëbisedimet me nxënësit rreth interesave dhe objektivave profesionale të tyre. Po ashtu, mund të përshkruani edhe mundësitë që keni identifikuar për punësimin e të diplomuarve nga kualifikimi në fjalë.

Infrastruktura

Në këtë pjesë mund të përshkruani kapacitetet infrastrukturore të shkollës që mundësojnë çeljen e kualifikimit profesional të ri, përfshirë numrin e klasave të nevojshme për mësimdhënien, të pajisjeve të ndryshme mësimore, si dhe bizneset partnere të gatshme për të bashkëpunuar me shkollën për çeljen dhe realizimin me sukses të kualifikimit të ri.

Stafi mësimor

Në këtë pjesë të fundit të relacionit, mund të paraqisni gjetjet nga analiza e kapaciteteve profesionale të shkollës, të cilat tregojnë se shkolla i ka mundësitë për të ofruar kualifikimin e ri. Në relacion mund të përfshini edhe një listë të mësuesve që do të angazhohen në mësimdhënie, përfshirë kualifikimet dhe përvojën e tyre.

Në përfundim, relacioni teknik përmbillet me nënshkrimin e koordinatorit/es së Njësisë së Zhvillimit.



Sugjerime për rastet kur shkolla vendos të çelë një kualifikim (drejtim/profil) profesional të ri

- Në rast vendimi për çelje të një kualifikimi (drejtimi/profili) të ri, sugjerohet që grupi i punës të parashikojë edhe mundësitë e shkollës për trajnim profesional të brendshëm, jo vetëm të stafit mësimor, por edhe të lektorëve të ftuar nga bizneset e zonës. Programi i trajnimit ndërtohet i tillë që të përmbushë nevojat e ndryshme të stafit mësimor për lëvrimin e kualifikimit të ri, si për shembull njohuri përmbajtësore, aftësi pedagogjike për mësimdhënien në institucionet e ofrimit të arsimit profesional, etj.

- Përpos përmbushjes së nevojave profesionale të stafit mësimor, trajnimi mund t'u vijë në ndihmë mësuesve dhe lektorëve të ftuar nga bizneset për përgatitjen praktike të dokumenteve kurrikulare në nivel ofruesi, si për shembull module teoriko-praktike, plane mësimore, materiale mësimore, etj.
- Për lëvrimin me sukses të kualifikimit të ri, sugjerohet që vendimi për çeljen të paraprihet nga marrëveshje mes shkollës dhe bizneseve të zonës ku nxënësit do të mund të kryejnë praktikën profesionale.



Vështirësi që mund të hasen gjatë procesit të vendimmarjes për çeljen e një kualifikimi (drejtimi/profil) profesional të ri

- Një vështirësi e mundshme që vlen të merret parasysh në rast çeljeje të një kualifikimi të ri është mungesa e qëndrueshmërisë së bashkëpunimit me bizneset e fushës. Nga përvoja, ky bashkëpunim mund të jetë afatshkurtër, gjë që krijon probleme në lëvrimin me sukses të kualifikimit në vazhdimësi. Për shembull, lektorë të ftuar nga bizneset mund të mos kenë mundësi të vazhdojnë të japin një modul teoriko-praktik. Ata mund të tërhiqen nga mësimdhënia për arsye të ndryshme, përfshi dhe për shkak të pagesës së ulët të orës mësimore.
- Një tjetër vështirësi mund të lindë nga mungesa e përvojës në mësimdhënie të lektorëve të ftuar nga bizneset. Kjo vështirësi mund të kapërxehet me anë të trajnimit të brendshëm të lektorëve si dhe mbështetjes së vazhdueshme nga drejtorja e shkollës dhe e stafit mësimor.
- Stafi mësimor mund të hasë në vështirësi në zbërthimin e kurrikulës së re dhe/ose në përgatitjen e dokumenteve kurrikulare në nivel ofruesi, si për shembull plane mësimore, materiale mësimore, etj. Trajnimi i brendshëm ose shkëmbimet e përvojave me mësues të fushës nga shkolla profesionale të tjera në rajon dhe më gjerë mund të ndihmojnë në kapërximin e kësaj vështirësie.



Një praktikë e mirë nga shkolla profesionale 'Kolin Gjoka' në Lezhë: Çelja e drejtimit të ri Teknologji Ushqimore në bashkëpunim me bizneset e zonës

Që prej vitit 2016, shkolla profesionale 'Kolin Gjoka' në Lezhë ka nisur ndërtimin e marrëdhënieve të partneritetit me bizneset e zonës sipas qasjes tek e tek të promovuar nga projekti "Aftësi për punë" (S4J). Mes bizneseve partnere janë edhe agro-turizmit 'Mrizi i zanave' dhe restoranti dhe hotelit 'Rapsodia'. Të dy sipërmarrësit, Altin Prenga dhe Alfred Marku, kanë treguar përkushtim ndaj praktikantëve të rinj. Ata kanë bashkëpunuar me projektin dhe shkollën për përmirësimin dhe përshtatjen e *skemës së praktikave*, një skemë e hartuar nga projekti, frymëzuar nga modeli zviceran i praktikës. Në kohën e rishikimit të Bordit Drejtues, shkolla 'Kolin Gjoka' i ftoi të dy këta sipërmarrës të bëheshin anëtarë të Bordit si përfaqësues të sektorit privat. Ata pranuan dhe, në takimin e parë, Altin Prenga u zgjodh drejtues i Bordit.

Në kohën kur shkolla firmosi marrëveshje bashkëpunimi me këto dy biznese, 'Mrizi i zanave' po ngrinte qendrën e vet të përpunimit ushqimor kurse 'Rapsodia' prej vitesh e kishte ngritur një kooperativë fermerësh që furnizon restorantin. Me forcimin e besimit se shkolla ishte e përkushtuar në pajisjen e nxënësve me aftësitë e nevojshme të tregut rajonal të punës, dy sipërmarrësit i kërkuan shkollës të merrte në shqyrtim hapjen e një programi që do të përgatiste specialistë në përpunimin e ushqimit. Hapja e një drejtimi të ri nuk është një sipërmarrje dhe aq e lehtë për një shkollë të mesme profesionale. Sipas procedurave, hapja e një drejtimi të ri kërkon miratimin e ministrisë së linjës. Për këtë, drejtuesi i shkollës duhet të argumentojë për nevojën dhe mundësitë e hapjes së drejtimit të ri. Në atë kohë, shkolla 'Kolin Gjoka' nuk kishte as burime financiare dhe as hapësirë për hapjen e laboratorëve të nevojshëm për drejtimin e ri. Për të hapur drejtimin e ri të përpunimit të ushqimit, kompanitë duhej të mbështesinin mësimin praktik nxënësve nga fillimi në fund.

Në 7 nëntor 2018 u organizua një *workshop* ku anëtarë të Bordit Drejtues, përfaqësues të sektorit privat, ftuan 13 kompani nga rajoni të specializuara në përpunimin e ushqimit. Në *workshop* u ftuan të marrin pjesë edhe Drejtuesi i Zyrës së Punës, një specialist nga AKAFPK-ja, si dhe drejtuesi dhe mësuesi të shkollës. Organizimi i *workshop*-it u lehtësua nga projekti S4J. Në përfundim, u identifikuan mangësitë në treg të aftësive të nevojshme në këtë sektor si dhe u siguroa përkushtimi i kompanive në:

- promovimin e drejtimit të ri në komunitet për të siguruar regjistrimin e nxënësve;
- përshtatjen e kurrikulës mësimore me kontekstin vendor;
- trajnimin praktik të mësuesve; dhe
- sigurimin me rotacion të vendeve për praktikën profesionale të nxënësve që do të regjistroheshin në këtë drejtim.

Të gjithë pikat e dakordësuara si më sipër u shkruan në një dokument në formën e një kërkesë të shkollës për çeljen e drejtimit të ri, kërkesë e cila u firmos nga të gjitha kompanitë e pranishme. Lehtësuesi i *workshop*-it dhe drejtuesi i shkollës përgatitën propozimin për miratim drejtuar Bordit Drejtues, bashkë me një relacion teknik. Pas miratimit të Bordit Drejtues, u përgatit një kërkesë për ministrinë e linjës (në atë vit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave), shoqëruar me miratimin e Bordit Drejtues dhe relacionin

teknik, ku u paraqit nevoja e tregut të punës dhe mundësitë e shkollës profesionale ‘Kolin Gjoka’ për çeljen e drejtimit të ri Teknologji Ushqimore në vitin e ardhshëm mësimor.

Ministria e linjës (Ministria e Ekonomisë dhe Financave) e miratoi kërkesën pas 6 muajsh. Në shtator 2019, 24 nxënës nisën studimet në drejtimin Teknologji Ushqimore. Brenda një viti, shkolla arriti të firmosë marrëveshje bashkëpunimi me 7 kompani ku nxënësit e këtij drejtimi mund të kryenin praktikën profesionale. Për shkollën ‘Kolin Gjoka’, çelja e një drejtimi të ri ishte një sfidë jo e vogël. Shkollës iu desh t’u tregojë kompanive të përpunimit të ushqimit, nxënësve dhe prindërve se kanë bërë zgjedhjen e duhur për një të ardhme profesionale të sigurt. Kjo sfidë u tejkalua me sukses si rezultat i përkushtimit të shkollës dhe mbështetjes së dhënë nga bizneset e zonës dhe projektit “Aftësi për punë” (S4J).

(këtu mund të vendoset figura që paraqet historikun e procesit siç paraqitet në raport, PH 2 S 1, fq. 27)

3.2.4 Në rast ofrimi të një moduli të ri me zgjedhje të detyruar

Në rast vendimi për ofrimin e një moduli të ri me zgjedhje të detyruar në kuadër të një kualifikimi profesional të caktuar, drejtorja e shkollës harton një propozim drejtuar AKAFPK-së. Ky propozim dërgohet në rrugë zyrtare në adresën e AKAFPK-së (info.akafp@akafp.gov.al), drejtuar Sektorit të Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse. Sipas Udhëzuesit për Shkollat Profesionale (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2023-24), hartuar nga AKAFPK-ja, propozimi duhet të bazohet te nevojat rajonale për kompetenca të veçanta profesionale sipas kualifikimit përkatës si dhe të argumentojë për kapacitetet profesionale dhe materiale të shkollës për zbatimin me sukses të modulit në fjalë. Kërkesa dërgohet brenda muajit shkurt. Drejtuesi i shkollës ndjek procesin e shqyrtimit të kërkesës nga AKAFPK-ja.




Vështirësi që mund të hasen gjatë procesit të vendimmarrjes për ofrimin e një moduli të ri me zgjedhje të detyruar

- Një vështirësi që vlen të parashikohet është mungesa e mundësive të shkollës për të trajnuar stafin mësimor për ofrimin e modulit të ri me zgjedhje të deetyruar. Mungesa e mundësive mund të ketë të bëjë me kufizime kohore, mungesë kapacitetesh profesionale për ofrimin e trajnimit, etj. Të gjitha këto sugjerohet të parashikohen dhe të zgjidhen para marrjes së vendimit për ofrimin e modulit të ri me zgjedhje të detyruar.

3.3 PLANIFIKIMI PËR LËVRIM

Faza e tretë dhe e fundit e procesit, *planifikimi për lëvrim*, është një fazë e rëndësishme në të cilën shkolla qartëson qëllimet dhe objektivat e diversifikimit të ofertës së re mësimore. Kjo fazë ka për synim planifikimin e çeljes së një apo më shumë kualifikimeve profesionale të reja dhe/ose të ofrimit të një apo më shumë moduleve të reja me zgjedhje të detyruar. Planifikimi për lëvrimin e ofertës së re mësimore mund të shtrihet përgjatë një periudhe disa mujore, duke nisur nga prilli e deri në dhjetor. Përrjashtim bën hapi i dytë, *promovimi i ofertës*, i cili mund të nisë më herët, që në muajin shkurt. Kjo fazë e fundit mund të realizohet në dy hapa kryesorë. Si hap i parë, shkolla mund të bëjë një planifikim të përgjithshëm, ku të marrë parasysh aspekte të ndryshme të ofertës mësimore si për shembull praktikën profesionale në biznes, materialet mësimore, infrastrukturën e nevojshme, përgatitjen e stafit mësimor, etj. Në një hap të dytë, shkolla mund të planifikojë promovimin e ofertës së re te nxënësit e shkollës dhe sektori privat.



Sugjerohet që grupi i punës për zbatimin e fazës së tretë të procesit të diversifikimit të ofertës së re mësimore, *planifikimi për lëvrim*, të përbëhet nga:

- (a) drejtuesi i shkollës
- (b) koordinatori i kurrikulës
- (c) koordinatori i marrëdhënieve me biznesin
- (d) koordinatori i orientimit në karrierë
- (e) koordinatori për marketingun institucional
- (f) koordinatori i zhvillimit të vazhduar profesionald
- (g) mësimdhënësit e praktikës profesionale

Në vijim paraqitet një përshkrim i detajuar i hapave të punës, përfshirë kontributin e nevojshëm të personave të angazhuar.

3.3.1 Planifikimi i përgjithshëm për lëvrimin e ofertës së re mësimore

Hapi i parë, *planifikimi për lëvrimin e ofertës së re mësimore*, mund të nisë në prill e të vazhdojë deri në shtator. Planifikimi i përgjithshëm shërben për të menduar në mënyrë strategjike dhe të detajuar aspekte të ndryshme të lëvrimin të ofertës së re mësimore. Në këtë mënyrë, shkolla iu del përpara vështirësive të mundshme dhe fuqizon pikat e forta ku do të mbështetet lëvrimi i ofertës së re. Disa prej aspekteve që vlen të merren parasysh gjatë planifikimit të përgjithshëm janë:

(a) Planifikimi i stafit mësimor

Brenda muajit qershor, drejtuesi i shkollës, me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës, planifikojnë stafin mësimor përgjegjës për ofrimin e kualifikimit të ri.

(b) Planifikimi i materialeve mësimore

Gjatë muajit qershor, koordinatori i kurrikulës, në bashkëpunim me mësuesit përgjegjës dhe me mbështetjen e drejtorisë së shkollës, planifikojnë materialet mësimore të nevojshme për lëvrimin e ofertës së re. Planifikimi i materialeve mësimore realizohet nëpërmjet konsultimit me një numër burimesh, disa prej të cilave sugjerohen si më poshtë:

1. **Lista e materialeve mësimore mbështetëse të përgatitura nga AKAFPK-ja.** Këto materiale gjenden në faqen zyrtare të AKAFPK-së si pjesë e dokumenteve kurrikulare (<https://www.akafp.gov.al>). Aty mund të gjeni 125 materiale mësimore në mbështetje të mësuesve të profileve mësimore të niveleve të ndryshme të KShK-së.
2. **Konsultimi me biznesin.** Kompanitë mund të ndajnë me shkollën materiale mësimore të nevojshme si për shembull, programe kompjuterike që përdoren në një profil të caktuar pune, udhëzime për përdorimin e makinerive të ndryshme, etj. Bashkëpunimi me biznesin në planifikimin e materialeve mësimore është veçanërisht i rëndësishëm kur materialet e nevojshme i njeh apo i zotëron dhe di t'i përdorë vetëm kompania në fjalë.
3. **Lista e materialeve mësimore digjitale në platformën online MësoVet** (<https://mesovet.al>).



Çfarë është platforma digjitale MësoVet dhe si ta përdorim atë?

MësoVET është një platformë digjitale në shqip, e ngritur në ndihmë të arsimit dhe formimit profesional. Platforma digjitale MësoVet është zhvilluar nga projekti “Aftësi për punë” (S4J) bazuar në Moodle Workplace. MësoVET ofron një hapësirë mësimore online të dedikuar për mësuesit dhe nxënësit ku

gjendet një gamë e gjerë e mjeteve dhe burimeve digjitale për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien në arsimin profesional. Përmbajtja e platformës përditësohet vazhdimisht nga mësuesit e shkollave partnere. Për këtë, ata janë mbështetur nga projekti nëpërmjet trajnimeve dhe udhëzimeve të nevojshme. Materialet e platformës bazohen në kurrikulën kombëtare dhe pasurohen me materiale praktike nga ekspertë të industrisë. Mësuesit mund t'i përditësojnë dhe t'i përdorin materialet në platformë pa pagesë. Edhe praktikantët mund ta kontribuojnë me materiale digjitale, si për shembull video të realizuara gjatë praktikës profesionale. Për këtë, praktikantët trajnohen paraprakisht. Videot shërbejnë si materiale mësimore për nxënësit e klasës X.

Në foton 3 më poshtë paraqitet një pamje e platformës ku mund të gjeni mjete të ndryshme për të digjitalizuar materialin mësimor.




Foto 3. Mjete mësimore digjitale në platformën MësoVet

Nga shkëmbimet e shumta të përvojave mbi mësimin e kombinuar, është parë se duke përdorur aktivitetet e platformës, realizohet një orë mësimore interaktive, lehtësohet bashkëpunimi mes nxënësve, ndiqet lehtësisht ecuria dhe krijohen evidencat e duhura për vlerësimin formues dhe përmbledhës të tyre.

Në këtë platformë gjenden materiale mësimore digjitale për 160 lëndë të teorisë profesionale në 7 drejtime por edhe një sërë funksionesh që ofron platforma për të mbështetur punën e mësuesve. Këto drejtime janë:

1. Hoteleri – Turizëm (24 lëndë + 10 module)

2. Ekonomi – Biznes (36 lëndë)
3. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (24 lëndë + 10 module)
4. Mekanika (19 lëndë/module)
5. Shërbim Mjetesh Transporti (ShMT) (14 lëndë)
6. Elektroteknika (17 lëndë)
7. Teknologjia Ushqimore (36 lëndë)

Fotoja 4 më poshtë paraqet një pamje nga platforma ku gjenden materialet mësimore digjitale të përshkruara më sipër.




Foto 4. Drejtimit dhe lëndët në platformën MësoVet

Përveç lëndëve ekzistuese, projekti S4J po mbështet hartimin e materialeve të reja mësimore digjitale për 78 lëndë të teorisë profesionale në degët TIK, Ekonomi Biznes, Hoteleri – Turizëm, Tekstil – Konfeksion, Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, Termo – Hidraulike, Ndërtim dhe Shërbim i Mjeteve të Transportit. Materialet e reja mësimore pritet të përfundojnë brenda vitit 2026.

Për arsye të privatësisë së të dhënave të përdoruesve, nuk është e mundur të krijohen profile përdoruesish në mënyrë të pavarur. Për të aksesuar burimet që MësoVET ofron, mund të ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Së pari, duhet të keni një profil aktiv në platformë. Për këtë, ju lutem kontaktoni projektin S4J duke vënë në dispozicion një dokument (sugjerohet që dokumenti të jetë në Excel) me të dhënat e mësuesve nga shkolla juaj që dëshirojnë të përdorin platformën. Të dhënat të përfshijnë emër,

mblidhet, adresë email aktive, si dhe drejtimin ku japin mësim. Kjo mund të përgatitet, për shembull, nga koordinatori e kurrikulave, e cila e dërgon tek adresa: mesovet.al@gmail.com.

2. Së dyti, stafi i projektit S4J harton dhe dërgon një listë me kredencialet (emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi) për çdo person të listës emërore, e cila u vihet në dispozicion mësuesve përkatës nga koordinatori e kurrikulës.
3. Më pas, mësuesit mund të hyjnë në platformën <https://mesovet.al> me kredencialet e përgatitura nga projekti S4J, të përditësojnë vetë të dhënat e profilit dhe të eksplorojnë në mënyrë të pavarur materialet dhe burimet e tjera që MësoVET ofron.

Fotoja 5 më poshtë paraqet një pamje nga platforma ku përdoruesi udhëzohet të lundrojë nëpërmjet shkollës ku ai/ajo punon.




Foto 5. Lundrimi në platformën MësoVet

Në platformë do të gjeni edhe video tutoriale të ndryshme, si për shembull:

- Udhëzime për mësuesit sesi të krijojmë një detyrë
- Udhëzime për mësuesit sesi të organizojmë një debat
- Udhëzime sesi të përdorim faqen MësoVet

Fotoja 6 më poshtë tregon disa nga videot tutoriale që mund të gjeni në platformën MësoVet.




Foto 6. Video tutoriale në platformën MësoVet

(c) Planifikimi i infrastrukturës

Gjatë muajit qershor, drejtori i shkollës, me mbështetjen e personit përgjegjës për financat, është mirë të planifikojnë infrastrukturën e nevojshme për lëvrimin e ofertës së re. Planifikimi i infrastrukturës mund të realizohet nëpërmjet përpilimit të një liste nevojash, në konsultim me inventarin e situatës infrastrukturore ekzistuese (**Shtojca 20**).

(d) Planifikimi i praktikës profesionale në biznes

Praktika profesionale në biznes është pjesë e procesit mësimor që zhvillohet në mjedise reale pune dhe kërkon planifikim dhe koordinim të vazhdueshëm mes shkollës dhe bizneseve. Për këtë arsye, brenda muajit qershor, është mirë që koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, me mbështetjen e drejtorisë së shkollës, të mësimdhënësit e praktikës profesionale dhe të koordinatorit të kurrikulës, të planifikojnë praktikën profesionale të nxënësve në bizneset e ndryshme të zonës. Planifikimi mundëson një fillim të mbarë dhe të mirëorganizuar të praktikës profesionale në biznes. Pjesë e punës së grupit është edhe përditësimi i bazës së të dhënave të bizneseve (**Shtojca 19**). Aty shtohen biznese të reja ku nxënësit mund të kryejnë praktikën profesionale dhe, nëse është e nevojshme, mund të hiqen bizneset që nuk ekzistojnë më ose me të cilat shkolla ka pasur përvoja jo të mira bashkëpunimi. Përditësimi i bazës së të dhënave të bizneseve mund të bazohet në vlerësimin e performancës së bizneseve partnere dhe përzgjedhjes së bizneseve të reja, vlerësim i kryer bazuar në parime dhe kritere që garantojnë cilësi. Për më shumë rreth kësaj, mund të shihni Udhëzuesin e Praktikave Profesionale në Kompani përgatitur nga projekti “Aftësi për punë” (S4J).

(e) Planifikimi i rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit mësimor

Gjatë periudhës gusht – shtator, koordinatori i zhvillimit të vazhduar profesional, me mbështetjen e drejtorisë së shkollës, vlen të planifikojnë rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit mësimdhënës përgjegjës për lëvizimin e ofertës së re mësimore. Në rastet kur shkolla ka staf të mirëpërgatitur për ofertën e re mësimore, mësuesit përgjegjës mund të vijojnë punën për përgatitjen e materialeve mësimore. Në rastet kur se mësuesit kanë nevojë për më shumë njohuri të fushës apo përmirësim të teknikave të mësimdhënies lidhur me ofertën e re mësimore, sugjerohet që shkolla të mbështesë rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet trajnimeve të ndryshme apo shkëmbimeve të përvojave të mira me shkolla të tjera.



Sugjerime për planifikimin e përgjithshëm për lëvizimin e ofertës së re mësimore

- Planifikimi i rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit mësimdhënës mund të lidhet me ciklin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.



Vështirësi që mund të hasen gjatë planifikimit të përgjithshëm për lëvizimin e ofertës së re

- Një vështirësi e mundshme për planifikimin e përgjithshëm është përditësimi i bazës së të dhënave të bizneseve. Kjo vështirësi mund të lindë për shumë arsye, duke nisur nga identifikimi i bizneseve të reja e deri te dakordësimi për bashkëpunim në lëvizimin e ofertës së re mësimore. Për këtë, sugjerohet që përditësimi i bazës së të dhënave të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, sa herë që shkolla njoftohet për hapjen e një biznesi të ri apo vihet në kontakt me një biznes të ri.
- Sugjerohet që marrëveshjet e bashkëpunimit me biznesin për zhvillimin e praktikës profesionale të realizohen para se shkolla të nisë procesin e orientimit në karrierë dhe të profilizimit të nxënësve.
- Është mirë që planifikimi i materialeve mësimore dhe i infrastrukturës të jetë realist, thënë ndryshe të marrë parasysh mundësitë e vërteta të shkollës për lëvizimin e ofertës së re.

- Shkolla mund të mos i ketë mundësitë për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit mësimor. Në këto raste, sugjerohet që drejtuesi i shkollës të lehtësojë shkëmbimin e përvojave të mira me mësues nga shkolla të tjera të zonës dhe më tej.
- Në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale, sugjerohet që shkolla të mbështesë stafin mësimor në përgatitjen e dokumenteve kurrikulare në nivel ofruesi, si për shembull plane mësimore, materiale mësimore, etj.

3.3.2 Promovimi i ofertës së re mësimore

Hapi i dytë, *promovimi i ofertës së re mësimore*, shërben për të informuar palët e interesuara mbi përparësitë e ofertës së re mësimore që do të ofrojë shkolla. Nëpërmjet promovimit, shkolla ndërgjegjëson nxënësit, prindërit dhe bizneset e zonës për nevojën e punonjësve të kualifikuar në drejtimin/profilin në fjalë dhe ashtu tërheq më shumë nxënës të interesuar në kualifikimin e ri. Ky hap mund të nisë që në muajin shkurt dhe të shtrihet deri në dhjetor. Promovimi mund të realizohet nëpërmjet një numri aktiviteteve, disa prej të cilave sugjerohen si më poshtë:

(a) Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve të marketingut

Gjatë muajit shkurt, koordinatori për marketingun institucional, me mbështetjen e koordinatorit për orientimin në karrierë, mund të planifikojnë aktivitete të ndryshme, të realizueshme brenda mundësive të shkollës, për promovimin e ofertës së re mësimore. Për këtë, ata përgatisin një kalendar me aktivitete të marketingut (**Shtojca 21**). Në kalendar vlen të paraqitet lloji i aktivitetit, objektivi kryesor, vendi dhe kohëzgjatja, si dhe personi përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e secilit aktivitet.

(b) Organizimi i aktiviteteve të marketingut

Aktivitetet e marketingut të parashikuara në kalendar realizohen duke filluar nga muaji qershor e deri në fund të dhjetorit nën mbikqyrjen e koordinatorit për marketingun institucional, me mbështetjen e drejtuesit të shkollës dhe të stafit mësimor. Për lehtësi organizimi, grupi i punës mund t'i ndajë aktivitetet e marketingut në dy periudha 3-mujore, *aktivitetet verore të marketingut* në periudhën qershor – shtator dhe *aktivitetet dimërore të marketingut* në periudhën tetor – dhjetor. Sugjerohet që koordinatori për marketingun institucional ta dokumentojë mbarëvajtjen e aktiviteteve me anë të një raporti përfundimtar të cilin ia dorëzon drejtorisë së shkollës. Ky raport mund të jetë pjesë e kalendarit të aktiviteteve të marketingut, ku në krahasim të secilit aktivitet të koordinatori mban shënime për mbarëvajtjen, vlerësime për organizimin, sugjerime për përmirësim në të ardhmen dhe aspekte të tjera të ngjashme lidhur me organizimin e aktiviteteve.

(c) Krijimi i partneriteve të reja me sektorin privat

Që në fillim të vitit shkollor, nga muaji korrik e deri në shtator, drejtuesi i shkollë, me mbështetjen e koordinаторit të marrëdhënies me biznesin, nisin punën për krijimin e partneriteteve të reja institucionale me biznese të ndryshme të zonës ku nxënësit do të mund të kryejnë praktikën profesionale. Për këtë, drejtuesi i shkollës dhe koordinatori i marrëdhënies me biznesin mund të ndjekin udhëzimet e parashtruara në dokumentin Menaxhimi i Marrëdhënies me Bizneset – Udhëzues për Ofruesit e Arsimit dhe Formimit profesional, përgatitur nga projekti “Aftësi për punë” (S4J).

(d) Identifikimi i lektorëve nga sektori privat

Është mirë që brenda muajit qershor, koordinatori i kurrikulës, me mbështetjen e koordinatorit të marrëdhënies me biznesin dhe të stafit mësimor që do të ofrojë kualifikimin e ri, të identifikojnë përfaqësues nga bizneset e zonës të cilët mund t’i ftojnë për të lëvruar tema mësimore sipas specialitetit përkatës. Përfaqësuesit nga sektori privat përzgjidhen bazuar në ekspertizën profesionale në tema të caktuara. Për shembull, ata mund të jenë shefa kuzhine në hotele të zonës apo koordinatorë guidash turistike. Koordinatori i kurrikulës mund të përgatisë fillimisht një listë lektorësh të mundshëm, të cilën më pas e përditëson në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me lektorët e kontaktuar (**Shtojca 22**).

(e) Promovimi i ofertës së re mësimore te nxënësit e shkollës

Gjatë muajit qershor, koordinatori i orientimit në karrierë, me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës, mund ta promovojnë ofertën e re mësimore për vitin e ardhshëm te nxënësit e shkollës.



Sugjerime për promovimin e ofertës së re mësimore

- Për të fituar kohë, sugjerohet që ndryshimet në ofertën mësimore të promovohen sa më herët, duke nisur menjëherë pas miratimit nga ministria e linjës.
- Krahas aktiviteteve të marketingut, grupi i punës mund të përgatisë edhe materiale promovuese për ofertën e re, si për shembull, fletë-palosje, video promovuese, etj.
- Për të informuar nxënësit sa më shpejt dhe pas kosto, shkolla mund të përdorë mekanizmat e promovimit në rrjetet sociale.

Bazuar në mundësitë e shkollës, një tjetër aktivitet promovues i ofertës së re mund të jenë edhe takimet informuese me grupe të ndryshme interesi si për shembull prindër, nxënës të shkollave 9-vjeçare, biznese, etj.



Vështirësi që mund të hasën gjatë promovimit të ofertës së re mësimore

- Koha në dispozicion nga miratimi deri në lëvrimin e ofertës së re mund të jetë e shkurtër dhe rrjedhimisht e pamjaftueshme për të zbatuar me sukses të gjitha hapat e sipërpërmendura. Në të tilla raste, sugjerohet që shkolla t'u japë përparësi hapave që mund t'i realizojë me efikasitet – në një kohë të shkurtër por me rezultat maksimal.
- Një tjetër vështirësi mund të lindë nga pamundësia për të bashkërenduar aktivitetet promovuese me institucionet e tjera arsimore të përfshira në këtë proces.
- Përfshirja në regjistrin e blerjeve të vogla e shpenzimeve për materialet promovuese për ofertën e ndryshuar mund të mos përputhet në kohë me blerjet aktuale.
- Në disa raste, për shkak të ngarkesës, edhe pse të gatshëm për t'u angazhuar në mësimdhënie, specialistë nga biznesi mund të kërkojnë që orari të përshtatet me kohën e tyre.



Një praktikë e mirë e diversifikimit të ofertës mësimore në shkollimin e mesëm profesional: Kthesa transformuese e shkollës 'Hamdi Bushati' në Shkodër

Shkolla 'Hamdi Bushati' në Shkodër u përfshi në projektin "Aftësi për punë" (S4J) në fund të vitit 2017. Në atë kohë, shkolla vuante nga një reputacion jo i mirë. Në 6 vitet e fundit, shkolla kish ofruar gjithsej 4 profile në 3 drejtimet studimore. Për vitin mësimor 2017-2018, 144 nxënës u regjistruan në 3 drejtimet që ofronte shkolla. Deri në 2017-n, shkolla nuk kishte asnjë bashkëpunim me kompanitë e rajonit. Mësimi praktik zhvillohej në laboratorët e shkollës. Në vijim paraqitet një përmbledhje e proceseve transformuese nëpër të cilat ka kaluar shkolla 'Hamdi Bushati' përgjatë 5 viteve mësimore nisur nga 2017-ta.

Biznesi vjen në shkollë dhe shkolla shkon në biznes

Gjatë vitit të parë, bazuar në qasjen e ndërveprimit tek e tek të projektit S4J, partneritetet shkollë – biznes u lidhën përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me gjithsej 34 kompani. Mes shumë konflikteve të brendshme të stafit të shkollës, tre mësues dolën vullnetarë për të mbështetur nxënësit të mësojnë në punë (*ëork based learning*). Brenda 5 viteve, duke nisur nga 2017-ta e deri në qershor 2022, 217 kompani kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shkollën 'Hamdi Bushati', nga të cilat 163 priten gjatë vitit shkollor 2021-2022, 443 nxënës gjithsej, rreth 60% e nxënëve të angazhuar në praktikë profesionale. Në vitin shkollor 2022-2023, shkolla nisi planifikimin e praktikës profesionale për nxënësit që në javën e dytë të vitit shkollor, në mënyrë që të arrinte objektivin e vendosur për atë vit: +70% e studentëve në praktikë. Duke nisur nga viti 2022, në shkollën 'Hamdi Bushati' është kthyer në normë pjesëmarrja e ekspertëve nga biznesi në mësimdhënie dhe/ose orë leksioni të hapur, në vlerësimin e provimeve, në pjesëmarrjen nëpër projekte të ndryshme vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, ëorkshop-e, etj.

Ndryshimet infrastrukturore dhe promovimi i shkollës në media

Drejtoria e shkollës punoi fort për të ndryshuar perceptimin e publikut për shkollën. Për këtë, me mbështetjen financiare të projektit, u rimodeluan mjediset e brendshme të shkollës me synim krijimin e një mjedisi tërheqës që i frymëzon nxënësit të ndihen krenarë dhe se i përkasin shkollës ku po përgatiten për profesionin e ardhshëm. Pas investimeve në hapësirat e brendshme të shkollës, stafi mësimor dhe nxënësit nisën një fushatë promovuese 'agresive' mbi parimin: 'Ne nuk lutemi për vëmendjen e medias, ne bëhemi lajmi (i mirë)'. Evenimente të ndryshme, shpesh të organizuara nga palë të treta, me pjesëmarrjen e kompanive, të nxënësve, prindërve dhe stafit mësimor e sollën shkollën në qendër të vëmendjes së shumë njerëzve në Shkodër. Për pasojë, në vitin shkollor 2018-2019 regjistrimet u rritën me 95%. Përpara fillimit të vitit shkollor 2024-2025, shkollës iu miratua çelja e programit të nivelit V të KShK-së, 'Menaxhimi i Strukturave Akomoduese. Përgatitja e nxënësve në këtë drejtim do të përmbushë nevojat e tregut rajonal për punonjës të kualifikuar në këtë fushë.

Diversifikimi i ofertës mësimore për të plotësuar nevojat e tregut të punës

Me shtimin e numrit të nxënësve të regjistruar, shkollës iu shtuan mundësitë për të aktivizuar më shumë profile në drejtimet që ofronte. Bazuar në të dhënat e gjurmimit dhe të dhënat e kompanive, shkolla vendosi të mos i ofrojë më disa profile për të cilat nuk kishte kërkesë në tregun e punës. Në vend të tyre, shkolla vendosi të ofrojë disa profile të reja më të sigurta për punësimin e nxënësve në të ardhmen. Si pasojë e këtij vendimi, shkolla u përball me një numër sfidash jo pak të vështira. Duke nisur nga viti mësimor 2018-2019, shkolla e pasuroi ofertën me një program të ri, i cili deri në vitin mësimor 2021-2022 arriti të përfshijë deri në 8 profile aktive. Kjo krijoi mundësi më të mira që nxënësit të zgjidhnin profilin bazuar në preferencat e tyre. Me ofrimin e programeve të reja, shkollës iu desh t'u qasej kompanive sipas sektorëve të rinj, si për shembull shitja me pakicë, sigurimet, modë, etj., dhe të përshtaste modelet e praktikave profesionale. Përveç kësaj, shkolla investoi shumë edhe në trajnimin e mësuesve, në zhvillimin e materialeve mësimore, si dhe në identifikimin, zhvillimin dhe promovimin e praktikave të mira

Studimi i tregut të punës

Pothuajse 3 në 4 të diplomuar nga shkolla e mesme profesionale 'Hamdi Bushati', rreth 73% e grupit të të diplomuarve në 2021, janë duke punuar një vit pas diplomimit, me 25 pikë përqindje mbi nivelin bazë (48%). Arritjet ishin edhe më të mira përsa i përket nivelit të të ardhurave. Numri i të diplomuarve që fitojnë 35 001 lekë neto një muaj u rrit gati 5 herë nga 14% (2017) në 68% (2021). Numri i të diplomuarve që fitojnë pagat më të larta (50 001 lekë neto në muaj) u rrit me mbi 5 herë nga 7% (2017) në 39% (2021).

REFERENCA

1. OECD. (2019). Education Indicators in Focus
https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2019/04/what-characterises-upper-secondary-vocational-education-and-training_7ae872d8/a1a7e2f1-en.pdf
2. AKAFPK. Skeletkurrikula
<https://www.akafp.gov.al/tabela-e-struktures-se-skeletkurrikula/>
3. AKPA
<https://aftesi.puna.gov.al/>
4. INSTAT
<https://www.instat.gov.al/>
5. MësoVet
<https://mesovet.al/>

SHTOJCA

- Shtojca 1: Model i Urdhërit për ngritjen e grupit të punës për diversifikimin e ofertës
- Shtojca 2: Vendimi për miratimin e kalendarit të aktiviteteve
- Shtojca 3: Listë kontrolli me të dhënat e ofertës aktuale të IOAFP-së
- Shtojca 4: Listë me treguesit kryesorë socio-ekonomik
- Shtojca 5: Proces-verbal i gjetjeve të analizës së praktikës profesionale
- Shtojca 6: Kriteret e sugjeruara për përzgjedhjen e kompanive, për tryezën e dialogut
- Shtojca 7: Listë me pyetje referenciale nga dialogu i strukturuar
- Shtojca 8: Sugjerime për organizmin e tryezës së dialogut
- Shtojca 9: Orientim për stafin dhe nxënësit për procesin e këshillimit dhe orientimit të karrierës
- Shtojca 10: Pyetësor për nxënësit e klasës së 11-të për zgjedhjen e profilit
- Shtojca 11: Pasqyrë përmbledhëse e preferencave të nxënësve
- Shtojca 12: Proces-verbali i takimit konsultues për raportin e gjetjeve
- Shtojca 13: Listë kriteresh për analizën e kapaciteteve të shkollës për lëvrimin e ofertës
- Shtojca 14: Kërkesë për miratim të ofertës së re mësimore drejtuar Bordit Drejtues
- Shtojca 15: Programi i mbledhjes së Bordit Drejtues
- Shtojca 16: Proces-verbali i takimit me Bordin Drejtues
- Shtojca 17: Kërkesë drejtuar ministrisë për çeljen e një kualifikimi të ri
- Shtojca 18: Angazhimi i biznesit në mbështetje të çeljes së një kualifikimi të ri
- Shtojca 19: Baza e të dhënave të bizneseve
- Shtojca 20: Lista e të dhënave infrastrukturore të shkollës
- Shtojca 21: Kalendari i aktiviteteve të marketingut
- Shtojca 22: Lista e lektorëve nga sektori privat

Shtojca 1: Vendim për krijimin e grupit të punës për diversifikimin e ofertës mësimore

Nr. _____ Prot.

[Qyteti], më ___/___/2024

URDHËR

Nr. _____ Datë _____

**PËR KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR DIVERSIFIKIMIN E OFERTËS
PËR VITIN SHKOLLOR _____**

Për realizimin e procesit të analizës së nevojave për diversifikim të ofertës mësimore, në shkollën profesionale **[Emri i shkollës]**, për vitin shkollor **[viti shkollor]**, urdhëroj:

1. Ngritjen e Grupit të Punës për Diversifikimin e Ofertës.
2. Përbërja e grupit të punës të jetë si më poshtë:

Kryetar	[Emër Mbiemër] , Drejtor
Anëtar	[Emër Mbiemër] , Zv/Drejtor
Anëtar	[Emër Mbiemër] , Përgjegjësi i Njesisë së Zhvillimit
Anëtar	[Emër Mbiemër] , Koordinator i Kurrikulës
Anëtar	[Emër Mbiemër] , Koordinator i Marrëdhënieve me Biznesin
Anëtar	[Emër Mbiemër] , Koordinator i Gjurmimit.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI
EMËR MBIEMËR**

Shtojca 2: Vendimi për miratimin e kalendarit të aktiviteveve

Nr. _____ Prot.

[Qyteti], më ___/___/2024

VENDIM

Nr. _____ Datë _____

Në kuadër të procesit të diversifikimit të ofertës në shkollën **[Emri i shkollës]**, mbështetur në propozimin e grupit të punës së diversifikimit të ofertës, ngritur me urdhër nr. **[numri i urdhërit]**, datë **[dd.mm.vvvv]**, nëpërmjet këtij vendimi, miratohet kalendari i aktiviteveve, për diversifikimin e ofertës, për vitin shkollor **[viti shkollor]**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI
EMËR MBIEMËR**

Shtojca 3: Listë kontrolli me të dhënat e ofertës aktuale të IOAFP-së

Listë kontrolli me të dhënat e ofertës aktuale të IOAFP-së

Viti shkollor	Oferta mësimore – Numri i regjistrimeve – Numri i diplomimeve
2023 - 2024	Niveli 2: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 3: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 4: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 5: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve]
2022 - 2023	Niveli 2: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 3: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 4: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 5: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve]
2021 - 2022	Niveli 2: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 3: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 4: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 5: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve]
2020 - 2021	Niveli 2: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 3: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 4: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 5: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve]
2019 - 2020	Niveli 2: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 3: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 4: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve] Niveli 5: [Emri i programit] – [Numri i regjistrimeve] – [Numri i diplomimeve]
...	

Sekretaria Mësimore

Shtojca 4: Listë me treguesit kryesorë socio-ekonomik

1. Struktura e popullsisë në qark
2. Treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë (15-64) vjeç, sipas qarqeve
3. Punëkërkues të papunë të regjistruar në DRAKPA sipas qarkut _____
4. Subjektet aktive që ushtrojnë aktivitetin në qarkun _____
5. Subjektet partnere me shkollën dhe zyrën e punësimit
6. Numri i nxënësve të klasave të IX në qarkun _____
7. Gjurmimi AP: Statusi i punësueshmërisë sipas drejtimeve
8. Gjurmimi FP: Statusi i punësueshmërisë sipas kurseve

1. Struktura e popullsisë së qarkut sipas grupmoshës

0-9 vjeç %	10-14 vjeç %	15-19 vjeç %	20-24 vjeç %	25-29 vjeç %	30- 65 vjeç, %	mbi 65 vjeç, %

2. Treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë (15-64) vjeç, sipas qarqeve

Qarqet	Shkalla e Pjesëmarrjes në forcat e punës	Shkalla e Punësimit	Shkalla e Papunësisë
Shqipëria			
Berat			
Dibër			
Durrës			
Elbasan			
Fier			
Gjirokastrë			
Korcë			
Kukës			
Lezhë			
Shkodër			
Tiranë			
Vlorë			

3. Punëkërkues të papunë të regjistruar në DRAKPA sipas qarkut _____

15-19 vjeç %	20-24 vjeç %	25-29 vjeç %	30- 34 vjeç, %	35- 39 vjeç, %	40- 44 vjeç, %	45-50 vjeç, %	Mbi 50 vjeç, %

--	--	--	--	--	--	--	--

4. Subjektet aktive që ushtrojnë aktivitetin në qarkun _____

Lloji i Aktivitetit	Numri i Subjekteve Aktive
Aktivite financiare dhe të sigurimit	
Administrimi publik dhe mbrojtja	
Sigurimi social i detyrueshëm	
Informacioni dhe komunikacioni	
Shërbime administrative dhe mbështetëse	
Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	
Shëndetësia dhe aktivite të punës sociale	
Transporti dhe magazinimi	
Ndërtimi	
Industria Përpunuese	
Aktivite të tjera shërbimi	
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve	
Total	

5. Subjektet partnere me shkollën dhe zyrën e punësimit

Aktiviteti Ekonomik	Biznese që kanë bashkepunim me IOAFP	Biznese që janë klientë të DRAKPA	Total biznese aktive në qark	%
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi				
Industria Nxjerrëse				
Industria Përpunuese				
Energjia elektrike, gaz, avull ajër i kondicionuar				
Furnizimi me ujë, aktivite të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve				
Ndërtimi				
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave				
Transporti dhe magazinimi				

Akomodimi dhe shërbimi ushqimor				
Informacioni dhe komunikacioni				
Aktivitete financiare dhe të sigurimit				
Aktivitete të pasurive të paluajtëshme				
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike				
Shërbime administrative dhe mbështetëse				
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm				
Arsimi				
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale				
Arte, argëtim dhe çlodhje				
Aktivitete të tjera shërbimi				

6. Numri i nxënësve të klasave të IX në qarkun _____

Shkollat e Qarkut	Numri i Nxënësve të klasës së IX
Shkolla _____	
Shkolla _____	
Shkolla _____	
Shkolla _____	
Shkolla _____	
Shkolla _____	
Shkolla _____	

7. Gjurmimi AP: Statusi i punësueshmërisë sipas drejtimeve

8. Gjurmimi FP: Statusi i punësueshmërisë sipas kurseve

Shtojca 5: Proces-verbal i gjetjeve të analizës së praktikës profesionale

Proces-verbal i gjetjeve të analizës së praktikës profesionale

Sot, më datë ___/___/, në shkollën _____, u mbajt Proces-verbal i gjetjeve të analizës së praktikës profesionale.

Nga gjetjet e analizës së praktikës profesionale, rezultojnë si më poshte:

- _____
- _____
- _____
- _____

Procesverbali u hartua nga koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, në bashkëpunim me mësuesit e praktikës profesionale.

Koordinatori i Marrëdhënieve me biznesin

Shtojca 6: Kriteret e sugjeruara për përzgjedhjen e kompanive, për tryezën e dialogut

Kriteret për përzgjedhjen e kompanive për tryezën e dialogut, mund të jenë të ndryshme. Më poshtë jepen disa kritere të sugjeruara:

- Biznes i qëndrueshëm
- Përkon me profilet/drejtimet e shkollës (aktuale ose potenciale)
- I hapur/ i gatshëm për bashkëpunim me shkollën
- Mbështetës/i hapur të promovojë ofertën e re
- Inovacioni: kompani që mund të ofrojë zgjidhje novatore, mund të kontribuoj në modernizimin e programit.
- E njëjtin sistem të arsimit të mesëm profesional
- Ka nevojë për praktikantë
- Ofron mundësi për punësim të mëtejshëm të nxënësve
- Një nevojat e tregut
- Aftësia për të kontribuar në mënyrë domethënëse në dialogun dhe veprimet e mëvonshme

Shënim:

Kriteret më sipër:

- nuk janë shteruese, sipas rastit IOAFP, mund të ndjekin edhe kritere të tjera.
- nuk janë domosdoshmerisht të gjitha të zbatueshme, grupi i punës mund të gjykojë cilat prej tyre janë të përshtatshme dhe të aplikueshme, sipas rastit.

Shtojca 7. Liste me pyetje referenciale nga dialogu i strukturuar

Pyetje referenciale per tryezat e dialogut te strukturuar

Informacion bazë	Emri i kompanisë
	Zona ku operon
	Vite në treg
	Shërbimet/produktet kryesore që ofron/prodhon
	Numri i punojësve në total
	Numri i punonjësve teknikë (psh. në shërbimin hotelier)
	Profilet e punës me më shumë punonjës

Niveli i pyetjes	Grupi i pyetjeve
Situata aktuale dhe potenciali për rritje në nivel kompanie	<p>Si ka ndryshuar kompania juaj në tre vitet e fundit në lidhje me numrin e punonjësve, shërbimet/produktet, infrastrukturën e saj?</p> <p>Pyetje për të orientuar përgjigjet gjatë këtij blloku:</p> <ol style="list-style-type: none"> A i plotësoni nevojat e kompanisë me stafin aktual? Ku janë mungesat më të mëdha (në sasi): në stafin teknik apo mbështetës? Sa është numri i vendeve të lira të punës momentalisht (staf teknik + staf mbështetës) A mund të bëni një parashikim për numrin e vendeve të lira të punës që do të duhen në tre vitet e ardhshme?
Artikulimi i nevojave për aftësi në nivel kompanie	<p>Si është niveli i aftësive/kompetencave të stafit tuaj aktual?</p> <p>Pyetje për të orientuar përgjigjet gjatë këtij blloku:</p> <ol style="list-style-type: none"> A i ka aftësitë/kompetencat e duhura stafi juaj? Arsimi i stafit tuaj (psh. AFP, universitet, dallime cilësore midis tyre)? Përgjithësisht, cilat janë 3 aftësitë kryesore (teknike dhe në plan të aftësive të buta) që ata kanë vs. ato që mungojnë? <p>Cfarë profesione/profile pune vëreni se ju mungojnë?</p>
Adresimi i nevojave për aftësi dhe mundësitë e bashkëpunimit me ofruesit	<p>Si do t'i adresoni këto nevoja për punonjës në nivel afat-shkurtër dhe afat-gjatë?</p> <p>Pyetje për të orientuar përgjigjet gjatë këtij blloku:</p>

	<p>a) Trajnime të brendshme (nga kompania), kurse afat-shkurtra, arsimit profesional, universitar?</p> <p>Si e shikoni një bashkëpunim më të ngushtë me ofruesit në rajon për të plotësuar nevojat tuaja (në mënyrë që oferta e tyre të jetë relevante me kërkesat tuaja)?</p> <p>Pyetje për të orientuar përgjigjet gjatë këtij blloku:</p> <p>a) Psh. modeli i praktikave profesionale/internshipe? Bashkëpunimi në zhvillimin e kurrikulave? Trajnimi i stafit mësimdhënës nga kompanitë tuaja? Te tjera?</p>
--	--

Për t'u mbajtur parasysh nga facilitatori:

- Roli juaj si facilitator është thelbësor, pasi ju jeni përgjegjës për ruajtjen e diskutimit në linjën e përmbushjes së objektivave dhe për sigurimin që çdo përfaqësues i biznesit të dëgjohet.
- Që në fillim të takimit është e nevojshme të theksohet qëllimi i takimit dhe të artikulohej 'Rregullat e lojës': ofruesit pritët të flasin vetëm gjatë bllokut të tretë të pyetjeve.
- Pyetjet duhet të jenë të hapura dhe të kalojnë nga pyetje të përgjithshme në pyetje specifike. Tek grupi i pyetjeve, pyetjet që duhen drejtuar janë pyetjet në bold, ndërsa nën-pyetjet, janë ato që mundësojnë orientimin e diskutimit.
- Është shumë e rëndësishme mbajtja e afatit kohor sipas programit.
- Takimi duhet të regjistrohet/për të mundësuar transkriptimin dhe të mbahen shënime

Shënim: Pyetjet më sipër, janë pyetje referenciale, orientuese, për të nxitur dhe drejtuar diskutimin. Në varësi të diskutimeve të pjesëmarrësve, mund të drejtohen edhe pyetje të tjera nga facilitatori, më qellim, identifikimin e nevojave që ata kanë për aftësi dhe kompetenca të reja, në strukturat e tyre.

Shtojca 8: Listë me pyetje referenciale nga dialogu i strukturuar

8.1 Sugjerime për organizimin e tryezës së dialogut

Organizimi i një tryeze dialogu me kompanitë dhe institucionet, për diversifikimin e ofertës, mund të përfshijë disa hapa. Disa sugjerime jepen më poshtë:

- Përcaktoni objektivat: Përshkruani qartë qëllimet e tryezës së dialogut.
- Identifikoni pjesëmarrësit: Përcaktoni se cilat kompani dhe institucione do të përfshihen.
- Vendi dhe logjistika: Zgjidhni një vend të përshtatshëm dhe organizoni mjediset e nevojshme.
- Orari dhe rendi i ditës: Caktoni një datë dhe krijoni një axhendë për veprimtarinë.
- Ftesat: Dërgoni ftesa për kompanitë dhe institucionet pjesëmarrëse
- Përgatitja e materialeve: Përgatitni çdo dokument apo material të nevojshëm për tryezën e dialogut.
- Prova: Bëni një test nëse elementët me sipër janë siguruar dhe janë të mjaftueshëm për organizimin e tryezës së dialogut
- Mekanizmi i feedback-ut: Planifikoni se si do të mblidhni feedback-un nga pjesëmarrësit.

8.2 Tryezat e Dialogut për Diversifikimin e Ofertës

Tryezat e Dialogut për Diversifikimin e Ofertës

Shkolla _____

Data, ora, vendi

PROGRAMI

09:45 – 10:00	Mbërritja e pjesëmarrësve/Regjistrimi	
10:00 – 10:05	Mirëseardhja dhe fjala hapëse	Drejtuesi i Shkolles / Kryetari i Bordit
10:05 – 10:20	Prezantim i qëllimit të Tryezës së dialogut për diversifikimin e ofertës	Moderatori
10:20 – 11:10	Diskutim mbi situatën aktuale dhe potencialin për rritje në nivel kompanie Diskutim mbi artikulin e nevojave për aftësi në nivel kompanie	Moderatori
11:10 – 11:50	Diskutim mbi adresimin e nevojave për aftësi dhe mundësitë e bashkëpunimit me ofruesit dhe nevoja për hapjen e drejtimeve/profileve/kurseve të kualifikimit	Moderatori
11:50 – 12:00	Mbyllja e takimit dhe hapat e mëtejshëm	Moderatori

Shtojca 9: Orientim për stafin dhe nxënësit për procesin e këshillimit dhe orientimit të karrierës

Nr.	Përmes këshillimit dhe orientimit të karrierës, synimi duhet të jetë që:
1	Nxënësit të identifikojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre
2	Nxënësit të aftësohen për të përgatitur CV
3	Nxënësit të aftësohen për të përgatitur Letër Motivimi
4	Nxënësit të njihen me listën e bizneseve partnere
5	Nxënësit të përgatiten për procesin e intervistës së punës
6	Nxënësit të kuptojnë trendet e tregut të punës sipas profesionit

Shtojca 10: Pyetësor për nxënësit e klasës së 11-të për zgjedhjen e profilit

Shembull: ZGJEDHJA E KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

I dashur nxënës, Ky pyetësor është krijuar për të ndihmuar në mbledhjen e preferencave dhe faktorëve që ndikojnë në përzgjedhjen për profilin që do të ndiqni në klasën e 12-të.

1. Emër Mbiemër _____

2. Drejtimi:

- Hoteleri-Turizëm
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Ekonomi-Biznes
- Shërbime sociale dhe shëndetësore
- Teknologji Ushqimore

3. Cilat janë prioritetet tuaja për zgjedhjen e profilit (Mund të zgjidhni më shumë se një)

- Interesi personal
- Rekomandimet e prindërve ose mësuesve
- Mundësitë e karrierës
- Nevojat e tregut të punës
- Preferenca për lëndë të caktuara

4. Nëse je në drejtimin Hoteleri-Turizëm cilin nga profilet dëshiron të ndjekësh në vitin e ardhshëm shkollor? (zgjidhni vetëm një)

- Kuzhinë-pastiçeri
- Shërbime në hotel dhe restorant
- Shërbime të Udhëtimit të Turizmit
- Bar-restorant
- Guidë-turistike
- Reepsion

5. Nëse je në drejtimin TIK cilin nga profilet dëshiron të ndjekësh në vitin e ardhshëm shkollor? (zgjidhni vetëm një)

- Zhvillim website
- Multimedia
- Mbështetës të përdoruesve
- TIK Rrjete të dhënash

6. Nëse je në drejtimin Ekonomi biznes cilin nga profilet dëshiron të ndjekësh në vitin e ardhshëm shkollor? (zgjidhni vetëm një)

- Tregti
- Llogari
- Sigurime
- Shërbime banke
- Sipërmarrje e agjencisë turistike
- Administrim zyre

7. Nëse je në drejtimin Shërbime sociale dhe shëndetësore cilin nga profilet dëshiron të ndjekësh në vitin e ardhshëm shkollor? (zgjidhni vetëm një)

- Shërbim kujdesi për fëmijë
- Shërbim kujdesi për të moshuar
- Animacion social

8. Nëse je në drejtimin Teknologji ushqimore cilin nga profilet dëshiron të ndjekësh në vitin e ardhshëm shkollor? (zgjidhni vetëm një)

- Teknologji e përpunimit të brumërave
- Teknologji e përpunimit të qumështit
- Teknologji e prodhimit të qumështit
- Teknologji e përpunimit të mishit dhe peshkut
- Teknologji e përpunimit të frutave dhe perimeve

9. Sa të rëndësishëm ishin për ju faktorët e mëposhtëm në zgjedhjen që bëtë (Vlerëso nga 1 shumë e rëndësishme deri 5 shumë pak e rëndësishme)

- Interesi personal
- Rekomandimet e të tjerëve
- Perspektivat e karrierës
- Aftësitë dhe rezultatet e mia
- Të ardhurat e mundshme në të ardhmen

Faleminderit!

Shënim: Secila nga shkollat mund të përshtatë pyetësoin, në varësi të drejtimeve dhe të profileve që ka pjesë të ofertës së saj të programeve të studimit.

Shtojca 12: Proces-verbali i takimit konsultues për raportin e gjetjeve

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË BORDIT DREJTUES TË SHKOLLËS PROFESIONALE**

Sot, më datë ___/___/, në shkollën _____, u mbajt mbledhja e Bordit Drejtues të Shkollës Profesionale. Mbledhja e drejtua nga kryetari i bordit z/znj.....

Mbledhja u zhvillua sipas rendit të ditës së parashikuar në axhendë.

Nga diskutimet, rezulton si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. Sipas rendit të ditës, u diskutua propozimi për hapjen e drejtimit/profilin/kursin të kualifikimit _____.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth mundësive, sfidave për hapjen e këtij drejtimi/profilin/kursin kualifikimi. Në fund anëtarët e pranishëm në këtë takim, votuan% pro në, për hapjen e këtij programi.
5.Të tjera.

Procesverbali u hartua nga sekretari i bordit z/znj.....

**Sekretari i Bordit
Emer Mbiemer**

Shtojca 14: Kërkesë për çeljen e një kualifikimi të ri drejtuar Bordit Drejtues të shkollës

Nr. _____ Prot.

Vendi, më __ / __ / ____

Lënda: Kërkesë për çeljen e kualifikimit profesional të ri _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____ në shkollën e mesme profesionale _____, drejtuar Bordit Drejtues të shkollës.

Të nderuar anëtarë të Bordit Drejtues të shkollës së mesme profesionale _____,

Në kuadër të punës për diversifikimin e ofertës mësimore, mbështetur në:

- a) analizën e nevojave të tregut të punës
- b) kapacitetet profesionale dhe materiale të shkollës
- c) nevojën e shprehur të sektorit privat për profesionistë të kualifikuar në fushën e _____
- d) të dhënat e grumbulluara nga Zyra e Punës

grupi i punës për diversifikimin e ofertës mësimore, ngritur me urdhër nr. _____, datë _____, paraqet për miratim të Bordit Drejtues kërkesën për çeljen e kualifikimit profesional të ri _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____ në vitin mësimor _____.

Vlerësojmë se ky kualifikim do të kontribuonte pozitivisht në plotësimin e nevojave të sektorit në fjalë.

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme, shpresojmë në miratimin e e kërkesës.

Propozojnë:

Miratojnë:

Drejtori

Emër Mbiemër

Anëtar Bordi

Emër Mbiemër

Anëtar Bordi

Emër Mbiemër

Anëtar Bordi

Emër Mbiemër

Kryetari i Bordit Drejtues

Emër Mbiemër

Anëtar Bordi

Emër Mbiemër

Anëtar Bordi

Emër Mbiemër

Anëtar Bordi

Emër Mbiemër

Shtojca 15: Njoftim për mbledhjen e Bordit Drejtues

NJOFTIM

PËR MBLEDHJEN E BORDIT DREJTUES TË SHKOLLËS PROFESIONALE

Nr _____ Prot.

Vendi, më ___ / ___ / ___

Drejtuar Z./Znj. _____, Kryetar / Nën Kryetar / anëtar i Bordit Drejtues të shkollës profesionale së mesme profesionale _____, përfaqësues i _____.

Në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.15/2017 'Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë " si dhe në zbatim të pikës 2 të Udhëzimit nr. 28, datë 30.7.2018 'Mbi kriteret për pjesëmarrjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit Drejtues të ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional', ju njoftojmë se më datë ___ / ___ / ___, ora _____, në ambjentet e _____ do të zhvillohet mbledhja e Bordit Drejtues të shkollës.

Në takim do të diskutohet për:

1. Shqyrtimi i propozimit për ofertën e re mësimore për vitin shkollor _____.
2. Të tjera

Drejtori

Emër Mbiemër

Shtojca 16: Proces-verbal i takimit me Bordin Drejtues

Proces-verbal i takimit me Bordin Drejtues

Nr. _____ Prot.

Vendi, më __ / __ / ____

Sot, më datë __/__/ , në shkollën e mesme profesionale _____, u mbajt takimi me Bordin Drejtues, në të cilin u diskutua oferta e re mësimore për vitin _____. Në takim morën pjesë:

1. _____
2. _____
3. _____

Gjatë takimit, anëtarët diskutuan dhe dhanë sugjerimet si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____

Në fund të takimit, u vendos:

1. Ofrim i modulit të ri me zgjedhje të detyruar: _____
2. Çelje e kualifikimit profesional të ri _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____

Sekretar i Bordit Drejtues

Emër Mbiemër

Shtojca 17: Kërkesë për çeljen e një kualifikimi profesional të ri drejtuar ministrisë së linjës

Nr. _____ Prot.

Vendi, më __ / __ / ____

Lënda: Kërkesë për çeljen e një kualifikimi profesional të ri

Drejtuar: Ministrisë _____

Në zbatim të ligjit nr. 15/2017, 'Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë', Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, 'Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive', Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, 'Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional', si dhe Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të shkollës, kërkojmë:

Miratimin për çeljen në shkollën e mesme profesionale _____ të kualifikimit profesional _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____.

Çelja e kualifikimit të ri realizohet në kuadër të diversifikimit të ofertës mësimore në shkollën e mesme profesionale _____, për vitin shkollor _____. Vlerësojmë se ka ardhur momenti i përshtatshëm për çeljen e këtij kualifikimi mbështetur në argumentet si më poshtë:

- a) Kualifikimi _____ i pajis nxënësit me kompetencat e nevojshme të kërkuara nga tregu i punës, të identifikuar nga analiza e nevojave realizuar nga shkolla gjatë vitit _____.
- b) Individu i certifikuar mund të krijojë një biznes privat, si person fizik ose juridik.
- c) Kërkesa është parashtruar nga biznese të vogla dhe të mesme që operojnë në këtë sektor, me të cilat shkolla ka marrëveshje bashkëpunimi.
- d) Tjetër:

Vlerësojmë se shkolla e mesme profesionale _____ i ka kapacitetet e nevojshme profesionale dhe infrastrukturore për çeljen e kualifikimit të ri. Këto kapacitete janë ngritur në vite edhe me mbështetjen e projektit 'Aftësi për punë' (S4J) dhe përfshijnë:

- a) Mjediset e shkollës janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për ofrimin e kualifikimit në fjalë. Në to mund të zbatohen lehtësisht modulet teoriko-praktike të kualifikimit të ri.
- b) Stafi mësimdhënës ka persona me kualifikimin dhe përvojën profesionale të nevojshme për realizimin me sukses të lëndëve dhe moduleve të këtij kualifikimi pasi janë trajnuar me mbështetjen e projektit 'Aftësi për punë' (S4J).
- c) Përfaqësues të biznesit janë të gatshëm të vendosin në dispozicion të shkollës specialistë të ndryshëm për të ofruar, sipas nevojës, leksione të hapura dhe të sigurojnë kushte për praktikën profesionale për nxënësit që do të regjistrohen në këtë nivel kualifikimi.
- d) Tjetër:

Duke vlerësuar mirëkuptimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë _____, shpresojmë në miratimin e shpejtë të kërkesës me qëllim çeljen e kualifikimit profesional _____ për vitin shkollor _____.

Bashkëlidhur po dërgojmë:

- a) Kërkesën për miratim nga Bordi Drejtues i shkollës
- b) Angazhimin e biznesit
- c) Relacionin e përgatitur nga Njësia e Zhvillimit

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe mbështetjen,

Drejtori

Emër Mbiemër

Shtojca 18: Angazhimi i biznesit në mbështetje të çeljes së një kualifikimit profesional të ri

Nr. _____ Prot.

Vendi, më __ / __ / ____

Lënda: Për çeljen e kualifikimit profesional _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____, në vitin shkollor _____, në shkollën e mesme profesionale - _____.

Në lidhje me çeljen e një kualifikimi profesional të ri _____ në nivelin ____ të KShK, kodi ____, në vitin shkollor _____, në shkollën e mesme profesionale _____, të nënshkruarit e kësaj shkrese, përfaqësues të bizneseve të zonës:

- konfirmojnë nevojën e tregut rajonal për punonjës të këtij kualifikimi;
- angazhohen të sigurojnë kushtet për praktikën profesionale për individët që do të regjistrohen në këtë nivel kualifikimi;
- angazhohen të vendosin në dispozicion të shkollës specialistë për të ofruar, sipas nevojës, leksione për nxënësit që do të ndjekin këtë nivel kualifikimi;
- tjetër:

Emri i biznesit, përfaqësuesi, firma

Emri i biznesit, përfaqësuesi, firma

Emri i biznesit, përfaqësuesi, firma

Emri i biznesit, përfaqësuesi, firma

Emri i biznesit, përfaqësuesi, firma

Shtojca 19: Baza e të dhënave të bizneseve

BAZA E TË DHËNAVE TË BIZNESEVE PARTNERE

Viti shkollor _____

Nr.	Kompania	Fusha e aktivitetit	Adresa	Personi i kontaktit	Tel./Cel.

Shtojca 20: Lista e të dhënave infrastrukturore të shkollës

TABELË PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE INFRASTRUKTURE TË SHKOLLËS

Viti shkollor _____

Nr.	Njësi infrastrukturore	Numër njësish	Vlera (për njësi)	Vlera (në total)
1	Shembull: Klasë			
2	Shembull: Laborator kompjuterash			
3	Shembull: Kuzhinë gatimi			

Shtojca 21: Kalendar i aktiviteteve të marketingut për promovimin e ofertës së re mësimore

KALENDARI I AKTIVITETEVE TË MARKETINGUT PËR PROMOVIMIN E OFERTËS SË RE MËSIMORE

Viti shkollor _____

Nr.	Aktiviteti	Objektivi	Vendi	Koha	Personi përgjegjës

Shtojca 22: Lista e lektorëve nga sektori privat

LISTA E LEKTORËVE NGA SEKTORI PRIVAT

Viti shkollor _____

Nr.	Lektori	Kompania	Fusha e ekspertizës	Drejtimi ku mund të japë mësim	Profili ku mund të japë mësim	Kontakti